



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 47 Akti

Nr. 25 Vendimi
Tiranë, më 20.06.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj
Brunilda Bekteshi
Olsi Komici

Kryesues
Relatore
Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Denisa Kosta, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në Tiranë, më datat 14 qershor 2018, ora 10:00 dhe 20 qershor 2018, ora 10:00, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Gentian Estref Trenova, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë, përfaqësuar nga avokati Saimir Lame, avokat i Dhomës së Avokatisë Tiranë, përfaqësuar me prokurë nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 30.05.2018.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Brunilda Bekteshi, subjektin e rivlerësimit dhe përfaqësuesin e tij, avokatin Saimir Lame, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi dhe bisedoi në tërësi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit Gentian Trenova, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 14.06.2018 kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Zoti Gentian Trenova është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si “Ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se: *“Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”*.

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë kandidat për anëtar të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në bazë të nenit 284 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtuar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (më poshtë referuar si “Komisioni”).

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: 1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe 3) Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 14.12.2017, të trupi gjykues nr. 3, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupit gjykues, z. Lulzim Hamitaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

Më datë 14.05.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit z. Gentian Trenova, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes.

Më datë 28.05.2018, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike; (iii) për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke

paraqitur kërkesë për njohjen me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike; (iv) përbërjen e trupit gjykues.

Më datë 05.06.2018, subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

Më datë 07.06.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 3 vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Trenova, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 14.06.2018, ora 10:00 paradite, pranë Pallatit të Kongreseve, kati i 2-të, Tiranë.

Më datë 14.06.2018 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent, bashkë me përfaqësuesin ligjor, avokatin Saimir Lame, i pajisur me prokurën nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 30.05.2018.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Trenova, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Seanca u zhvillua në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jabobs. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Trenova, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit iu përgjigj pyetjeve të bëra nga trupi gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar.

Subjekti i rivlerësimit depozitoi pranë Komisionit parashtrimet e tij, me shkrim, në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ dhe dokumentacionin, të cilat ishin të njëjta me ato të dërguara pas kalimit të barrës së provës. Në përfundim të parashtrimeve dhe përgjigjeve të pyetjeve të bëra, subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Trenova, kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në bazë të të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”*, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Trenova. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 14.06.2018, për të rifilluar më datë 20.06.2018 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Gentian Trenova ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Komisioni, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, kreu një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, për vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme, në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, fshehje të pasurisë, deklaram të rremë apo konfliktin e interesit, në referim të dispozitave ligjore nr. 84/2016, sipas të cilave procesi i hetimit administrativ bazohet në nenin 45, *“Rregullat e përgjithshme të hetimit të çështjes”*, *“Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për*

procedurën e rivlerësimit”. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni mund të kërkojë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.”

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; procesverbalet e anketimit të subjektit të rivlerësimit, të mbajtur pranë ILDKPKI-së në janar të vitit 2016; c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, datë 05.06.2018, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; dh) deklaratimet e personave të tjerë të lidhur, e) faktet e njohura botërisht.

A. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar me shkresën nr. (***) prot., datë 17.11.2017, raportin lidhur me vlerësimin e pasurisë, ku konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Trenova:

- *Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Ka kryer deklaram të rremë; si dhe*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive në pronësi, përdorim, deklaratimeve të rremë apo konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 33, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

Mbi asetet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

Pasuri e paluajtshme: Apartament në Rr. “(***)”, p. (***), sh. (***), ap.(***)).

Burimi i krijimit: Kredi pranë “Alpha Bank”. Ndryshuar pronësi në nëntor të vitit 2012, përmes kontratës së dhurimit personave të tjerë. Vlera 1.900.000 lekë, pjesë takuese 100 %.

Lidhur me këtë pasuri, ILDKPKI ka konkluduar se nga ana e subjektit deklarues ka deklarim të rremë për ligjshmërinë e burimit të shumës 1.900.000 lekë për blerjen e apartamentit të banimit në Rr. “(***)”, p. (***), sh. (***), ap. (***), Tiranë, më datë 27.06.2007, për shkak se çmimi

deklarohet i paguar jashtë zyrës noteriale (pa përcaktuar mjetin e pagesës), ndërsa deklarohet një kontratë për kredi bankare në shumën 28.000 euro, për të njëjtën pasuri.

1.1. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave kërkoi dhe administroi:

Shkresën e “Alpha Bank” nr. (***)prot., datë 29.01.2018, regjistruar pranë Komisionit me nr. (***)prot., datë 30.01.2018, e cila konfirmon likuiditetet e subjektit, personave të lidhur, si dhe personave të tjerë të lidhur, si dhe disponimin e plotë të akteve lidhur me kredinë e marrë;

Shkresën nr. (*) prot., datë 03.01.2018** dhe nr. (***) prot., datë 03.01.2018, drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Ndërsa me shkresën nr. (***) prot., datë 01.02.2018, (regjistruar në KPK me nr. (***) prot., datë 02.02.2018) ZVRPP Tiranë ka dërguar praktikën për pronësinë e këtij apartamenti;

Shkresën nr. (*) prot., datë 23.02.2018**, drejtuar noteres R. S. dhe noteres E. H., duke kërkuar kopje të plotë nga arkivi noterial i akteve që i përkasin kontratës noteriale nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 07.06.2007;

Shkresën e noteres E.H. (nr. (***) prot., datë 26.02.2018, të Komisionit), e cila mundësoi praktikën shkresore që i përket nënshkrimit të kontratës noteriale nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 07.06.2007;

Procesverbalin e anketimit, datë 14.01.2016 dhe 22.01.2016, përpara ILDKPKI-së, ku subjekti kishte dhënë deklaratimet e tij për këtë pasuri;

Komisioni kreu përlllogaritjet financiare lidhur me aftësinë paguese të shumës 12.000 euro, të cilat u bazuan në:

- ✓ Të ardhurat nga paga të subjektit të rivlerësimit;
- ✓ Arkëtimet e ndryshme dhe pagesat për blerje të regjistrueshme;
- ✓ Gjendjen e kursimit që deklaroi subjekti në Deklarimin Vjetor të Pasurisë (DVP) në ILDKPKI për vitet 2004, 2005, 2006 dhe 2007;
- ✓ Datimi/muaji qershor 2007, kur është kryer pagesa;
- ✓ Kontrata e shitjes me rezervë, nr. (***)rep., nr. (***) kol., datë 07.06.2007, ku parashikohej se pagesa *cash* kryhej menjëherë më datë 07.06.2007.
- ✓ Kurs këmbimi 124.3 lekë/euro, kursi i datës që kishte Banka e Shqipërisë në vitin 2007.

Në analizën financiare u mbajtën në konsideratë edhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me likuiditetet ndër vite, si më poshtë:

- Subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar në vitin 2004 gjendje *cash* të likuiditeteve shumën 800.000 lekë, dhe në procesverbalin e mbajtur më 14.01.2016 në ILDKPKI (për pyetjen “10”, subjekti i rivlerësimit konfirmonte se: “...*dispononte vetëm 600.000 lekë të bashkëshortes, pasi gjendjen e deklaruar në vitin 2004, prej 800.000 lekësh, e kishte shpenzuar për martesë (viti 2011)*”.
- Subjekti i rivlerësimit, në vitin 2005 e për çdo vit, nuk rezultonte të kishte deklaruar shtesa ose pakësime të likuiditeteve, *cash*, në shtëpi; Subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar vetëm në vitin 2015 shumën 600.000 lekë dhe në vitin 2016 kishte deklaruar shumën 500.000 lekë. Duke e krahasuar gjendjen *cash* të vitit 2016, me deklaratën e vetting-ut, rezultonte se subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar shtesa ose pakësime në këto raste, por gjendjen totale të likuiditeteve *cash*.

Në tabelën e mëposhtme gjenden të reflektuara të ardhurat e krijuara për të justifikuar¹ këtë pasuri/likuiditet 1 janar 2007 - 7 qershor 2007 (muaji kur ishte kryer pagesa).

Nr.	Përshkrimi	Data	Vlera LEK	Konstatime të veprimeve bankare të subjektit
1	Gjendje e likuiditeteve në bankë në fillim të vitit	1 janar 2007	802.247	
-	Depozitë në "FIB"		700.000	Kërkohej mbyllja e llogarisë më datë 18.6.2007, tërhiqen <i>cash</i> dhe përdoren për qëllime <u>personale dhe familjare</u> (sipas p.v. datë 22.1.2016 - pyetja 1) . Është marrë në llogaritje sepse për disa ditë mund të përdorë gjendjen <i>cash</i> dhe të zëvendësohet më tërheqjen nga banka.
-	Llog. rrjedhëse në "Raiffeisen Bank"		102.247	
2	Gjendje <i>cash</i> në shtëpi	1 janar 2007	800.000	Mbahen në të njëjtën gjendje deri në v. 2011 – përdoren për shpenzime dasme (p.v. datë 14.1.2016 – pyetja 10)
3	Të ardhura nga paga	1 janar - 1 qershor 2007	512.615	
	Paga mujore	09.01.2007	82.694	
		01.02.2007	84.944	
		01.03.2007	84.944	
		02.04.2007	79.612	
		02.05.2007	95.269	
		01.06.2007	85.152	
4	Gjendje e likuiditeteve mbas pagesës së apartamentit (në bankë)	11.06.2007	504.835	Tërhequr datë 13.06.2007 shuma 494.800 lekë (kjo shumë nuk mund të llogaritet për blerjen e apartamentit, sepse shuma 12.000 euro ishte parapaguar që më datë 07.06.2007, sipas kontratës, dhe nuk deklarohet nga subjekti për këtë destinacion).
-	Llog. e pagës me nr. (***)në "Raiffeisen Bank"		504.835	
5	Gjendja <i>cash</i> në shtëpi		800.000	
6	Shpenzime sipas INSTAT (Anketa e buxhetit të familjes me një person 26.308 lekë x 5 muaj)	Janar-maj 2007	131.540	
7	Shpenzime për udhëtim në Milano, dy net. Udhëtuar me linjën (***) MILANO (***) , gjithsej 280 euro (bileta llogaritur 180 euro +100 euro hotel & ushqim)	07.5.2007	38.867	
8	Blerë apartamentit (12.000 euro)	07.06.2007	1.491.600	
	Diferenca e pajustificuar (1+2+3-4-5-6-7-8)		- 851.980	

1.2 Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 14.05.2018, të trupit gjykues nr. 3, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit dhe, më datë 28.05.2018, njoftoi subjektin e rivlerësimit se mund të njihet me dokumentet e dosjes dhe se Komisioni ka arritur në

¹ Subjekti për blerjen e apartamentit me kontratë shitjeje me rezervë nr. (***) rep., (***) kol., datë 07.06.2007, kishte kryer pagesën menjëherë *cash* më datë 07.06.2007, shumën prej 12.000 eurosh (ose 1.491.600 lekë me kurs këmbimi 124.3 lekë/euro, kursi i BSH në këtë datë).

përfundimin se provat e administruara në lidhje me këtë pasuri kanë nivelin e provueshmërisë, duke i dërguar subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit kryesisht; duke njoftuar subjektin se i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë rezultuan dyshime të arsyeshme për:

- a. Deklarim të rremë, për kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie, nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 07.06.2007, si dhe çmimin e blerjes së këtij apartamenti, që sipas kontratës së datës 07.06.2007 ishte për një çmim 40.000 euro (krejtësisht e likuiduar), dhe jo për çmimin 1.900.000 lekë;
- b. Deklarim të rremë dhe fshehje e pasurisë/likuiditetit në vlerën 12.000 euro, në Deklaratën-Vetting, deklarimet vjetore në ILDKPKI, si dhe në deklarimet dhe shpjegimet që subjekti ka dhënë në komunikimin elektronik me Komisionin;
- c. Subjekti i rivlerësimit nuk kishte pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e pasurisë/likuiditetit në vlerën në vlerën 12.000 euro (*sipas analizës financiare si më poshtë referuar*);
- d. Ndërmarrjen nga ana e subjektit të veprimeve fiktive në ZVRPP Tiranë, sa i takonte regjistrimit të kontratës së fitimit të pronësisë, si dhe të çmimit të vërtetë të transaksionit, veprime që cenojnë rëndë pastërtinë e figurës dhe të etikës së magjistratit.

1.3 Ndërsa subjekti i rivlerësimit, më datë 05.06.2018, dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij², po ashtu edhe në seancën dëgjimore të datës 14.06.2018. Ndër të tjera, për këtë pasuri, subjekti është shprehur se:

Kontrata paraprake ishte firmosur me qëllim marrjen e kredisë nga blerësi. Kishte pasur të ardhura të mjaftueshme nga pagat e tij për pagesën e vlerës prej 12 mijë eurosh, e cila ishte paguar me tri faza, me mirëkuptim me shitësin, si më poshtë:

- Më datë 07.06.2007, kishte paguar shumën prej 300.000 (treqind mijë) lekësh, të cilën e kishte marrë nga pjesa *cash*, që kishte pasur gjendje në vitin 2007.
- Kishte përdorur një pjesë nga fondi prej 800 mijë lekësh që kishte gjendje *cash* që prej vitit 2004, të cilin edhe pse e ka deklaruar si shpenzim për martesë në vitin 2011, shprehet se: *"...Përmendja për shpenzime për martesë ka qenë një nga rastet e shpenzimit, pasi nga kjo shumë është shpenzuar në drejtime të ndryshme dhe vlera të ndryshme dhe kohë të ndryshme, të cilat nuk i kujtoj dhe nuk i kam mbajtur mend në kohën e deklarimit në vitin 2016..."*.
- Më datë 18.06.2007 kishte paguar shumën prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh, e shoqëruar me dokumentin bankar mbi tërheqjen e shumës prej 494.800 (katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind) lekësh më datë 13.06.2007, nga llogaria e pagës në bankën "Raffaisen".
- Më datë 20.06.2007 kishte paguar shumën prej 700.000 (shtatëqind mijë) lekësh, tërhequr nga depozita në "First Investment Bank".
- Kredia e akorduar më datë 29.06.2007 kishte kaluar në llogarinë e shitëses, znj. S.H., e cila e kishte tërhequr plotësisht po atë ditë. Nga kjo shumë prej 27. 700 eurosh, e tërhequr, ishte mbajtur vlera prej 400.000 (katërqind mijë) lekësh dhe pjesa tjetër e mbetur i ishte kthyer cash subjektit të rivlerësimit nga shitësit, znj. Sh. dhe z. A. H.

² Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje.

- Vlera prej 12 mijë eurosh, e paguar para kontratës përfundimtare, ishte pjesë e shumës prej 1.900.000 lekësh. Kjo vlerë prej 12 mijë eurosh ishte rivendosur pas marrjes së kredisë dhe ishte shpenzuar në drejtime të ndryshme. Shpenzimet më pas të kësaj shume i kishte bërë në drejtime, kohë dhe shuma të ndryshme, të cilat nuk i kujtonte.
- Nga vlera e kredisë së marrë, prej afro 28.000 eurosh, zbret shumën prej 400.000 (katërqind mijë) lekësh, që i kishte dhënë shitësit ditën e marrjes së kredisë. Pastaj, nga shuma prej 28 mijë eurosh, i ishte zbritur shuma prej 12 mijë eurosh, paguar më parë shitësit.
- Pjesën e mbetur, prej 13 mijë eurosh (28.000 – 12.000 – 3.000), e kishte përdorur për riparimin e shtëpisë dhe mobilimin e saj.
- Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar gjithashtu se shpenzimet e udhëtimit të përlogaritura nga Komisioni kishin qenë për arsye pune.
- Në seancën dëgjimore ka shpjeguar se nga ana e Komisionit i ishte komunikuar për fshehje apo pasaktësi, por nuk i ish bërë precize cilat janë, sa është vlera e pasaktë e pasurisë, e padeklaruar, për apartamentin e blerë në vitin 2007.

1.4 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, mbështetur në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike, sipas pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, provat shkresore të administruara, sipas neneve 49 dhe 50 të po këtij ligji, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, arsyetonte se:

Në lidhje me krijimin e kësaj pasurie, ka deklarim të rremë për burimin e ligjshëm financiar, si dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e saj, për vitin 2007, **provuar kjo me:**

1. Shkresën nr. (***) prot., datë 23.02.2018, të noterit publik, znj. E. H., ku konfirmohet një marrëdhënie tjetër juridike kontraktore midis subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur, A. dhe Sh. H., kontrata noteriale nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 07.06.2007, përveç asaj të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, kontratë shitjeje nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 27 qershor 2007, për blerjen **e së njëjtës pasuri në vlerën 19.000.000 lekë** (pagesa të kryera jashtë zyrës noteriale);
2. Kontratën noteriale të datës 07.06.2007, nga ku konfirmohet se për të njëjtin apartament çmimi i **blerjes ishte 40.000 euro;**
3. Shkresën e “Alpha Bank”, nr. (***) prot., datë 29.01.2018, nga ku konfirmohet se kredia është disbursuar më datë 27.06.2007, në vlerën 28.000 euro;
si dhe
-Nxjerrjen e llogarisë në përdorim të subjektit të rivlerësimit pranë “Alpha Bank”, nga ku konfirmohet se më datë 29.06.2007, subjekti ka kryer pagesa me transfertë për znj. Sh. dhe z. A. H., me përshkrim “*Nga Gentian Trenova për Sh. e A. H. / pagesë sipas kontratës nr. (***) kol., nr. (***) rep., datë 07.06.2007*”, në vlerën 27.710 euro;
4. Shkresën me nr. (***)prot., datë 01.02.2018 të ZVRPP Tiranë, nga ku konfirmohet se më datë 30.06.2007, subjekti i rivlerësimit ishte pajisur me certifikatë pronësie, sipas kërkesës nr. (***) datë 28.06.2007, e regjistruar prona me vlerë 1.900.000 lekë sipas kontratës së shitjes nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 27 qershor 2007, nga e njëjta notere, znj. E. H.;

5. Deklarimet e subjektit me anë të postës elektronike, datë 16.03.2018, përmes së cilave, pranohet pagesa jashtë zyrës noteriale e shumës prej 12.000 eurosh, me burim krijimi të kësaj shume- kursime nga paga dhe honorarë;
6. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në procesverbalet/anketimin e kryer pranë ILDKPKI-së, në janar të vitit 2016, lidhur me arsyet e marrjes së kredisë në shumën 28.000 euro në “Alpha Bank”, ndërkohë që apartamenti i blerë ishte deklaruar në vlerën 1.900.000 lekë”. Subjekti i rivlerësimit deklaroi: “...*duke qenë se ka qenë tejet i amortizuar, një pjesë të mirë të kredisë e kam shpenzuar për riparim tërësor të apartamentit dhe për blerje për arrendim të tij*”.
7. Mospërputhjet e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me kronologjinë dhe përmbajtjen e veprimeve juridike që ka kryer, si dhe me materialet shkresore që u siguruan në kuadër të hetimit të thelluar. Subjekti të rivlerësimit i është kërkuar të japë shpjegime në mënyrë të përsëritur lidhur me pagesën e çmimit të apartamentit, mbi të ardhurat që ka përdorur për blerjen e kësaj pasurie, shpenzimet, si nga institucioni i ILDKPKI-së, ashtu edhe gjatë hetimit administrativ, për të cilat rezultuan mospërputhje për sa më poshtë:

Më datë 05.03.2018, pranë Komisionit, subjekti i rivlerësimit përmes deklarimeve të tij ka pranuar se kjo pasuri është blerë me kursime nga paga dhe honorarë, ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2007 ka deklaruar vetëm apartament 50 m², kurse në atë Deklaratën-Vetting ka deklaruar si burim krijimi: marrje kredie tek “Alpha Bank”³;

Po në datën 05.03.2018, subjekti i rivlerësimit jep përshkrime të përgjithshme sa u përket punimeve të kryera apo riparimeve, por nuk i kujtohen datat apo periudhat e kryerjes së punimeve, shumat e shpenzuara, si dhe nuk ka mbajtur apo ruajtur asnjë dokument (faturë) për shpenzimin e kryer. Por, subjekti ka deklaruar se: “... *burimi i të ardhurave kanë qenë ato të ardhura nga **paga dhe shpërblimet në punë**, si dhe nga **kredia e marrë në “Alpha Bank” në vitin 2007, në vlerën 28 mijë euro***”. Po në këtë datë, ka deklaruar se: “...*Është e vërtetë se në deklaratën time të parë, në lidhje me transaksionin e bërë për apartamentin e blerë në vitin 2007, jam shprehur se kam bërë punime në lidhje me apartamentin*”.

Ndërkaq, më datë 05.06.2018, me anë të shpjegimeve me shkrim të depozituara, ashtu si edhe në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë vlerën e punimeve: “...*Pjesa e mbetur prej 28.000 – 12.000 – 3.000 = 13 mijë euro, e përdorur, siç kam deklaruar më parë, për riparimin e shtëpisë dhe mobilimin e saj*”.

Komisioni çmon se deklarinimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, se të ardhurat për transaksionin e blerjes, riparimin dhe arredimin/mobilimin e apartamentit ishin përballuar nga kredia prej 28.000 eurosh, që kishte marrë nga “Alpha Bank”, bien në kundërshtim me:

- Deklarimet e dhëna prej tij, se blerja e kësaj pasurie ishte kryer me parapagimin e shumës 12.000 euro, që buronin nga kursimet nga të ardhurat nga paga, të cilat u rikuperuan nga kthimi i shumave të marra tepër nga znj. Sh. H.;
- Me deklarinimet në ILDKPKI, për një nga zërat (kursime prej 800 mijë lekësh) që subjekti përdor si të ardhur për parapagesën prej 12 mijë eurosh, për të cilën ka deklaruar: “... *unë disponoj vetëm gjendjen prej 600.000 lekësh të bashkëshortes, pasi gjendjen 800.000 lekë, të deklaruar në vitin 2004 e kam shpenzuar për martesë*”. Referuar pyetjes nr. 10 të procesverbalit të datës 14.01.2016, keni deklaruar pakësimin e gjendjes cash të 800.000

³ Specifikisht deklaroi se apartamenti është blerë në bazë të kredisë së marrë në “Alpha Bank”, në vitin 2007. Apartamenti ka ndryshuar pronësi në muajin nëntor 2012, me dhurim personave të tjerë.

lekë për shpenzime martese. Përse nuk është deklaruar pakësimi i gjendjes cash në vitin përkatës?” Subjekti ka deklaruar se: “Pakësimi është bërë në vitin 2011 për shkak të martesës”.

- ✓ Pretendimi i subjektit në seancën dëgjimore, se nga ana e Komisionit i ishte komunikuar për fshehje apo pasaktësi, por nuk i ishin bërë precize se cilat janë, nuk qëndron, pasi Komisioni përmes njoftimit të rezultateve të hetimit kryesisht, e ka njohur subjektin mbi rrethanat konstatuese, provat ku ishte mbështetur, analizën financiare dhe metodologjinë e përdorur, duke përfshirë çdo detaj referues të saj, që nga lëvizjet e llogarive bankare, deklaramet e bëra nga ana e tij dhe deri te kursi i këmbimit zyrtar të përdorur.
- ✓ Komisioni çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se vlera prej 12 mijë eurosh ishte parapaguar me mirëkuptim me palën blerëse, në tri faza⁴, mbetet në kuadër deklarativ, si dhe nuk provohet me dokumentacion ligjor për këto pagesa, sikurse nuk provohet as kthimi i shumës cash prej 24.700 eurosh (27.700 euro – 3000 euro), nga shitësit Sh. dhe A. H. te subjekti i rivlerësimit.
- ✓ Komisioni çmon se deklarata noteriale e nënshkruar nga një prej shitëseve, e depozituar nga subjekti i rivlerësimit më datë 30 maj 2018, bie në kundërshtim me aktet e deklaruara e nënshkruara nga palët në atë periudhë, si dhe faktet e konstatuara dhe të vërtetuara me materialet shpresore të siguruara nga “Alpha Bank” sh.a., ZVRPP Tiranë dhe notere E.H., sa i takon transaksionit për blerjen e apartamentit më datë 7 qershor 2007 dhe më datë 27 qershor 2007.
- ✓ Ky pretendim nuk qëndron edhe për faktin se këto transaksione nuk janë reflektuar në deklaratën periodike të vitit 2007, nga subjekti i rivlerësimit, as si gjendje pasurore në fund të vitit 2007, burimi i krijimit të tyre, dhe as si shpenzime vjetore.

Në këtë drejtim, sipas pretendimit të subjektit, në asnjë prej deklarameteve periodike vjetore dhe as në Deklaratën-Vetting nuk rezultoi të jenë deklaruar:

- ***të ardhura, që erdhën nga kthimi i shumave nga pala shitëse;***
- ***likuiditeti i gjendjes cash, si rikuperim i shumës 12 mijë euro në deklaratën periodike të vitit 2007;***
- ***shpenzimi i vlerës prej 13 mijë eurosh, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, si shpenzim për ristrukturim e mobilim të këtij apartamenti.***

Komisioni, lidhur me këto shpenzime çmon se subjekti i rivlerësimit, edhe pse kishte barrën e provës, nuk depozitoi asnjë faturë për t’i provuar ato.

Në mbështetje të provave të siguruara, analizimit të fakteve dhe rrethanave të arsyetuara më lart, Komisioni çmon se kjo pasuri është blerë përmes kontratës së shitjes me rezervë nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 07.06.2007, për një çmim prej 40.000 eurosh.

Në konsideratë të kësaj kontrate, si investim i subjektit të rivlerësimit në vlerën 40 mijë euro dhe deklaramet të subjektit përmes shpjegimeve të tij më datë 05.06.2018, se për ristrukturim e mobilim të këtij apartamenti është shpenzuar vlera prej 13 mijë eurosh, Komisioni kreu përllogaritjet financiare të gjendjes pasurore për vitin 2007.

- ✓ Të ardhurat nga paga e tij në shumën 1.110.356 lekë dhe të ardhura nga shpërblime, dieta, shërbime, shuma 47.600 lekë, gjithsej **1.157.956 lekë**.

⁴ Shiko në fq. 8.

- ✓ Pasuria: **4.114.356 lekë**.
 - Blerja e apartamentit në vlerën 40.000 euro, e konvertuar me kursin e këmbimit mesatar 120.91 lekë/euro të vitit 2007 të marrë nga arkiva e Bankës së Shqipërisë) shuma **4.836.400 lekë**.
 - Pakësuar likuiditetet, duke tërhequr nga Banka Parë e Investimeve shumën 700.000 lekë dhe nga llogaria e pagës 22.044 lekë, gjithsej **722.044 lekë**.
- ✓ Marrë kredi në shumën 28.000 euro, duke e llogaritur me të njëjtin kurs këmbimi, 120.91 lekë/euro, gjithsej **3.385.480 lekë**, duke shlyer këst kredie (principal) 116.132 lekë.
- ✓ Pasuri neto: **728.876 lekë** (4836400-3385480-722044).
- ✓ Shpenzime: **1.792.005 lekë**.
 - Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së, 168.000 lekë.
 - Interesa për këstin e kredisë, 52.175 lekë.
 - Shpenzime për rikonstruksion dhe arredim shtëpie: ka deklaruar se ka shpenzuar 13.000 euro, e konvertuar me kursin e këmbimit mesatar 120.91 lekë/euro të vitit 2007, të marrë nga arkiva e BSH-së, gjithsej 1.571.830 lekë.
 - Shpenzimi për udhëtim jashtë shtetit, gjithsej 38.867 lekë.

Nr.	ANALIZA FINANCIARE	Viti 2007
1	Të ardhurat	1.157.956
2	Ndryshimi i pasurisë	4.114.356
3	Detyrimet	3.269.348
	Pasuria neto	845.008
4	Shpenzimet	1.830.872
	Diferenca	- 1.517.924

Lidhur më përlogaritjet financiare, në një nga zërat e shpenzimeve, ai i udhëtimit, në Milano, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar se ky udhëtim ka qenë për arsye pune nga ana e institucionit të Prokurorisë. Komisioni çmon se shpjegimi i subjektit të rivlerësimit, në kushtet ligjore të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për barrën e provës, gjendet i pambështetur në provë shkresore, që të vërtetonte rimbursimin e tyre, si e tillë u llogarit si shpenzim për udhëtim jashtë vendit.

Nga përlogaritja financiare, sipas deklarimeve të subjektit në raport me gjendjen pasurore të tij për vitin 2007, vit në të cilin subjekti i rivlerësimit ka kryer blerjen e kësaj pasurie, Komisioni konkludon se:

Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme (të ardhura nga paga dhe kredia) për blerjen e apartamentit me vlerë 40.000 euro, në raport me shpenzimet për rikonstruksionin e apartamentit dhe ato jetike, duke rezultuar kështu me mungesë burimi të ardhurash për këtë vit, në shumën: - 1.517.924 (minus një milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e katër) lekë.

Komisioni lidhur me konstatimin se subjekti i rivlerësimit ka lidhur dy kontrata për të njëjtin pasuri, me çmime blerjeje të ndryshme, në analizim të fakteve⁵, rrethanave dhe veprimeve të

⁵ Neni 45, pika 2, i ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: "Gjatë hetimit administrativ, Komisioni mund të kërkojë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të këtij ligji. Ata administrojnë dokumente që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit",

ndërmarrja nga ana e subjektit, si dhe bazuar në provat e siguruar gjatë hetimit administrativ, arsyetohet:

Kontrata e datës 07.06.2007 i plotëson kriteret e kontratës së shitjes me rezervë, e cila ka prodhuar efektet e saj në mënyrë të plotë. Ky fakt lidhet me natyrën juridike të kontratës së shitjes me rezervë, sipas të cilit, kur çmimi i shitjes është caktuar të paguhet me këste, blerësi e fiton pronësinë parashikuar në nenin 746 të Kodit Civil, ku citohet se: *“Kur çmimi i shitjes paguhet me këste, blerësi e fiton pronësinë e sendit me pagimin e kështit të fundit të çmimit, duke marrë përsipër rrezikun që në çastin e dorëzimit. Kalimi me rezerve të pronësisë, me kushtin e sipërm, duhet të pasqyrohet në kontratë”*. Sikurse rezultoi nga verifikimi i llogarive bankare të palëve, çmimi është likuiduar tërësisht dhe në kontratë është parashikuar se: *“Me nënshkrimin e kësaj kontrate noteriale, me likuidimin e të gjithë shumës së shitjes dhe me regjistrimin e saj në Z.R.P.P, pala shitëse e humbet çdo të drejtë pronësie të apartamentit, ndërsa pala blerëse bëhet pronar”*.

Kontrata e shitjes së të njëjtës pasuri, 21 ditë më vonë, para të njëjtit noter, me çmim më të ulët (vlera 1.900.000 lekë) dhe e përdorur për regjistrimin e pasurisë, është fiktive, pasi kontrata e datës 07.06.2007 i kishte përmbushur kushtet e saj.

Sa më sipër, i referohemi edhe nenit 681 të Kodit Civil, ku theksohet se: *“Kur interpretohet një kontratë, duhet që të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës, duke u bazuar në objektin, si dhe detyrimet e marra përsipër”*. dhe nenit 659 të Kodit Civil parashikohet se: *“Kontrata nuk është gjë tjetër, veçse një veprim juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”*.

Në këtë kuptim, që kontrata e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme, si veprim juridik, të jetë e vlefshme, është e domosdoshme, përveç sa parashikohet në nenin 79 të Kodit Civil, të plotësohen edhe kushtet e parashikuara në nenin 663 të Kodit Civil dhe konkretisht, pëlqimi i palëve, *“përveçse shkaku i ligjshëm, objekti i kontratës të jetë i përcaktuar dhe i ligjshëm, si dhe forma e kërkuar ligjore”*.

Bazuar në provat e administruara, arsyetimin ligjor, Komisioni çmon se shprehja e vullnetit të subjektit të rivlerësimit për lidhjen e dy kontratave për të njëjtën pasuri, si dhe **ndërmarrja e veprime fiktive në ZVRPP Tiranë, sa i takonte regjistrimit të kontratës së fitimit të pronësisë, si dhe të çmimit të vërtetë të transaksionit**, janë veprime që cenojnë rëndë pastërtinë e figurës dhe të etikës së magjistratit.

Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të kësaj pasurie, sipas nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, sipas nenit D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës.

2. Pasuria - Shtesë kati mbi apartamentin në Rr. “(*)”, p. (***), sh. (***), ap. (***) (kati (***))**

Lidhur me këtë pasuri, ILDKPKI-ja -bazuar edhe në një denoncim anonim, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit kishte realizuar një ndërtim pa leje mbi apartamentin që kishte blerë në Rr. “(***)”, p. (***), sh. (***), ap. (***) (kati (***)), Tiranë, duke e shndërruar këtë apartament prej 50 m² në një banesë me dy nivele të integruara me shkallë të brendshme (dupleks), -ka konkluduar se:

- subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratat e tij të interesave privatë dhe në Deklaratën-Vetting ndërtimin e shtesës së katit, shpenzimet e kryera për ndërtimin dhe mobilimin e tij, si dhe ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për këtë investim;

- ndërtimi i paligjshëm i pasurisë “shtesë kati” bie në kundërshtim jo vetëm me ligjin penal shqiptar (ndërtimi i paligjshëm parashikohet si vepër penale në nenin 199/a të Kodit Penal), por edhe me funksionin e subjektit, si dhe komprometon shumë rëndë figurën e tij si prokuror pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Gjithashtu, ILDKPKI-ja ka çmuar fiktive, e për pasojë të rremë, deklarin mbi qëllimin e kalimit të pronësisë së apartamentit në Rr. “(***), p. (***), sh. (***), ap. (***), Tiranë, te personat e tjerë të lidhur, vjehri dhe vjehrra e subjektit të vlerësimit (z. H. dhe znj. L. P), nëpërmjet dhurimit me kontratën noteriale nr. (**) rep., nr. (**)kol., datë 21.11.2012 (noter, z. J. Zh.), për shkak se, qëllimi i vërtetë i këtij veprimi juridik ishte krijimi i mundësive për përfitime të padrejta nga ana e tyre.

Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e kësaj pasurie

2.1. Komisioni, për vërtetimin e faktit të ndërtimit të shtesës së katit dhe burimit të të ardhurave, kërkoi dhe administroi:

Shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, nr. (**) prot., datë 11.01.2018, përmes së cilës Komisioni u informua mbi një deklarin për ndërtim në zonën nën juridiksion të ALUIZNI-t “Tirana 2”. Ndërsa nga Drejtoria e ALUIZNI-t “Tirana 2”, me shkresën nr. (**) prot., datë 25.01.2018, jepet informacion mbi aplikimin e nënshkruar nga bashkëshortët, z. H. dhe znj. L. P., si dhe dokumentacioni që disponohet nga ky institucion për këtë praktikë.

Shkresën e Drejtorisë së ALUIZNI-t “Tirana 2” nr. (**) prot., datë 09.02.2018, e cila konfirmoi se shtesa e katit (**), sipër ap. (**) në p. (**) në Rr. “(***), Tiranë, është e legalizuar me lejen e legalizimit nr. (**), datë 25.09.2014. Nga ky institucion u sigurua informacioni se: aplikues (vetëdeklarues) të përfshirjes në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje janë H. P. dhe L. P. (sipas kërkesës nr. (**)prot., datë 26.06.2013).

Shkresën e ZVRPP-së, nr. (**)prot., datë 01.02.2018, si dhe dokumentacioni shoqërues bashkëlidhur, pjesë e fashikullit të provave. Nëpërmjet akteve që bashkëlidhen si fashikull me këtë shkresë, prezantohet historiku i zhvillimit të pasurisë që i përket ap. (**), p. (**), Rr. “(***). Me anë të kësaj shkrese, Komisioni u informua se shtesa e katit mbi apartamentin nr. (**), p. (**), Rr. “(***), Tiranë, është regjistruar si pasuri më vete, si dhe të gjitha veprimet dhe formalitetet administrative janë nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Trenova.

Shkresën e OSHEE sh.a.-së, nr. (**)prot., datë 18.01.2018, si dhe me procesverbalin e verifikimit nr. (**), datë 08.01.2018, me anë të së cilës konfirmohet se pasuria dupleks furnizohet vetëm me një kontratë energjie elektrike dhe ka si titullar të saj subjektin e rivlerësimit.

Shkresën e UKT-së, nr. (**)prot., datë 25.01.2018, me anë të së cilës konfirmohet se pasuria “dupleks” furnizohet vetëm me një kontratë shërbimi ujësjellës-kanalizim nr. (**), dhe ka si titullar të saj subjektin e rivlerësimit.

Shkresat drejtuar bankave të nivelit të dytë⁶ mbi verifikimin e të ardhurave të llogarive bankare, si dhe të aktiviteteve të bashkëshortëve, H. P. dhe L. P.

⁶ Nr. (**)prot., datë 09.01.2018 FIB; Nr. (**) prot., datë 10.01.2018 NGB; Nr. (**) prot., datë 11.01.2018, “Raiffeisen Bank”; Nr. (**)tbo- (**)prot., datë 19.01.2018, Societe Generale Alb.; Nr. (**)prot., datë 22.01.2018, Intesa Sanpaolo; Nr. (**)prot., datë 22.01.2018, PRO CREDIT; Nr. (**) prot., datë 23.01.2018, “Union Bank”; (**) prot., datë 23.01.2018 BKT; Nr. (**) prot., datë 29.01.2018, Alpha Bank; Nr. (**) prot., datë 16.02.2018, Credins Bank; Nr. (**) prot., datë 08.03.2018, BKT;

-Shkresë nr. (**) prot., datë 03.01.2018 – drejtuar A. T. Pronave; kthyer përgjigje negative me shkresën nr. (**) prot., datë 12.01.2018; -Shkresë nr. (**) prot., datë 03.01.2018 – drejtuar QKB-së; kthyer përgjigje negative me shkresën nr. (**) prot., datë 19.01.2018;

Procesverbalet e anketimit, përpara ILDKPKI-së, datë 14.01.2016 dhe 22.01.2016, ku subjekti kishte dhënë deklaratimet e tij për këtë pasuri.

Trupi gjykues, gjatë shqyrtimit të akteve të administruara nga institucionet e sipërpërmendura konstatoi se:

Në fashikullin e akteve të gjendura në dosjen e legalizimit nuk rezultonte të ishte i regjistruar ndonjë akt shkresor, që shprehte miratimin e banorëve të pallatit nr. (***) , që sipër apartamentit (***) të ndërtohet një kat shtesë, që zinte sipërfaqen e përbashkët të banorëve; fotografitë e objektit nuk i përkisnin objektit të ndërtuar; nuk ishte përcaktuar asnjë pagesë e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, fakt i konstatuar edhe nga Auditimi i Pavarur i Kontrollit të Lartë të Shtetit⁷, si dhe kishte mospërputhje të vitit të ndërtimit të objektit mes periudhës së evidentuar në ekspertizë (viti 2008) dhe asaj që konstatohet nga sistemi *Google Map* (viti 2013). Gjithashtu, u vërejt se e gjithë procedura e aplikimit, këqyrjes së objektit, ekspertimit të tij, shqyrtimit administrativ të kërkesës nga ALUIZNI “Tirana 2” dhe deri te lëshimi i lejes së legalizimit kishte zgjatur vetëm 15 muaj.

Subjekti i rivlerësimit kishte nënshkruar një kontratë noteriale dhurimi, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 21.11.2012, përpara realizimit të ndërtimit pa leje, duke ia dhuruar apartamentin e tij z. H. dhe znj. L.P., prindërit e bashkëshortes J. P., person i lidhur.

Me anë të postës elektronike, në mënyrë të përsëritur, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të japë shpjegimet e tij lidhur me titullin juridik që ai kishte mbi këtë pasuri, për të cilën subjekti deklaroi se kjo pasuri, shtesa prej 50 m² (kati i (***)-të) mbi apartamentin në Rr. “(***)”, p. (***) , sh. (***) , ap. (***) (kati i (***)-të), Tiranë, ishte ndërtuar në periudhën 2012 - 2013, nga vjehri i tij, z. H. P. dhe vjehrra e tij, znj. L. P., pasi këta ishin bërë pronarë të ligjshëm të apartamentit; kostoja e ndërtimit mund të kishte arritur në shumat **1.500.000 – 2.000.000 lekë**, për të cilat nuk disponohen akte shkresore.

Sa i takon *burimit të ligjshëm të të ardhurave për personat e tjerë të lidhur*, për këtë ndërtim, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- **të ardhura** që vinin nga një shpronësim i vjehrrës, nga një pasuri e paluajtshme në bashkëpronësi, për interesa publike me një VKM të vitit 2012, në shumën 1.385.719 lekë (që e gjejmë të shprehur edhe në procesverbalin e datës 14.01.2016 në ILDKPKI, por me tjetër destinacion përdorimi të kësaj shume);
- **të ardhura** që vinin nga një vendim gjykate (vendimi nr. (***) , datë 25.06.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. (***) , datë 20.10.2014, të Gjykatës Apelit Administrativ);
- **të ardhura** që vinin nga të ardhurat personale të dy bashkëshortëve, z. H. dhe znj. L. P., nga pagat dhe nga të ardhurat e vjehrrit H. P. si trajner në sportin e peshëngritjes.

Lidhur me deklarinimin e të ardhurave të personave të lidhur, Komisioni kreu analizën financiare të llogarive bankare të z. H.P. dhe znj. L. P., e cila pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

-Shkresë nr. (***) prot., datë 03.01.2018 – drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; kthyer përgjigje me shkresat nr. (***) prot., datë 12.02.2018;

-Shkresë nr. (***) prot., datë 03.01.2018 – drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë; kthyer përgjigje negative me shkresat nr. (***) prot., datë 23.01.2018, dhe nr. (***) , datë 02.02.2018;

-Shkresë nr. (***) prot., datë 26.01.2018, drejtuar D.Raj. të Sigurimeve Shoqërore Tiranë; kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 01.02.2018;

-Shkresë nr. (***) prot., datë 06.02.2018 – drejtuar Ministrisë së Drejtësisë (R.Sh.Noterial); kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 12.01.2018 (bashkëlidhur listë me veprimet noteriale).

⁷ Refero shkresën e KLSH-së, Nr. (***) , datë 30.03.2018.

Metodologjia e përdorur u bazua në përlllogaritjet dhe analizimin e:

- *gjendjes në banka me të ardhurat nga paga, arkëtime të ndryshme dhe pagesat, dhe për blerje të regjistrueshme* që rezultojnë në emër të z. H. P. dhe znj. L. P. në periudhën: pas datës së fitimit të pronësisë së apartamentit (datë 21.11.2012) deri në datën e deklarimit të ndërtimit të shtesës (datë 26.06.2013);
- *-likuiditete nëpër banka*, që i kanë tërhequr *cash*, por nuk vërtetohet që t’i kenë shpenzuar për ndërtimin e shtesës, si **fatura të blerjes së materialeve të ndërtimit**, madje detyrimisht me pagesa bankare për ato materiale që kalojnë vlerën 360.000 lekë me TVSH;
- *destinacioni i përdorimit të burimit të të ardhurave* të personave të tjerë të lidhur, z. H. P. dhe znj. L. P.;

Pasqyrat financiare e llogarive bankare të personave të tjerë të lidhur, z. H. P. dhe znj. L.P.: 21 nëntor 2012- 26 qershor 2013 në Bankën Kombëtare Tregtare.

Nr.	Emri/Mbiemri i klientit	Data	Depozituar	Tërhequr	Përshkrimi
1	H. P. Llog. nr. (***)	18.08.2016	11.000 euro		“Cash depozitë” shuma e tërhequr nga “Raiffeisen Bank”
	Llog. page nr. (***) nga maj 2014	13.08.2015		300.000 lekë	Tërheqje <i>cash</i>
2	L. P.	19.07.2006	20.000 euro		Derdhje <i>cash</i>
		20.10.2006		11.127 euro	
3	Depozitë	2006	9.000 euro		Vendosur Depozitë 3-mujore
		07.02.2007		1000 euro	
		07.08.2007		2.056 euro	
		2007	6.000 euro		Maturim depozite
		2008	6.000 euro		Maturim depozite
		2009	6.000 euro		Maturim depozite
		11.08.2010		6.000 euro	Mbyllje Depozitë 3-mujore

“Raiffeisen Bank”

Nr.	Emri/Mbiemri i klientit	Data	Depozituar	Tërhequr	Përshkrimi
1	H. P. Llogari bankare me nr. (***) lekë				
2	Transfertë e ardhur nga llogaria personale e L. P.	18.05.2015	7.500.000 lekë		Transferim fondi
3	Depozitë me afat	25.06.2015	7.500.000 lekë		
4	Tërhequr	25.06.2015		5.772.800 lekë	Për blerje apartamenti në Qerret
5	Këmbim në euro	17.08.2015		1.537.800 lekë	Vendosur depozitë në euro
6	Llogari depozite (***)-EUR-	17.08.2015	11.000 euro		
7		18.08.2016		11.000 euro	Tërhequr nga llogaria
8	L. P.				
9	Llog. kursimi nr. (***)	01.10.2004	300.000 lekë		
10		10.01.2005		300.000 lekë	Tërhequr fondi
11	Depozitë	10.12.2010	500.000 lekë		Me afat 6-mujor
12		12.06.2012	801.223 lekë		Kalim fondi
13		12.06.2012		1.300.000 lekë	
14	Bono thesari	13.06.2012	1.350.000 lekë		Bono thesari 12-mujore

Të ardhurat në tabelën e mëposhtme pasqyrojnë:

- ✓ të ardhurat në emër të znj. L. P. që kishin si burim: kontratë qiraje nr. (***), datë 12.02.2007, me Njësia Bashkiake Nr. (***), Tiranë (referuar shënimit të bankës);
- ✓ të ardhurat e arkëtuara nga dëmshpërblimi për shpronësimin me VKM;
- ✓ të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit nr. (***), datë 25.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. (***), datë 20.10.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit (në shumat: 9.933.333 lekë dhe 3.000.000 lekë, më datë 15.05.2015).

Nr.	Data	Shuma e depozituar LEK	Shuma tërhequr LEK	Përshkrimi i transaksionit
1	22 shkurt 2007 deri më 19 dhjetor 2007	1.923.696	1.763.352	Qira sipas kontratës (***), datë 12.02.07, nga Njësia Bashkiake Nr. (***) (11 transaksione)
2	Viti 2008	1.763.388	1.920.600	Qira sipas kontratës (***), datë 12.02.07, nga Njësia Bashkiake Nr. (***) (9 transaksione)
3	Janar-qershor 2009	961.848	960.000	Qira sipas kontratës (***), datë 12.02.07, nga Njësia Bashkiake Nr. (***) (9 transaksione)
4	25.04.2012	1.385.719		Nga shpronësimi me VKM
5	30.04.2012		615.000	Tërheqje <i>cash</i>
6	07.05.2012		800.000	Kalim fondi për depozitë
7	13.03.2015	400.000		Pagesë për ekzekutimin e vendimit nr. (***), datë 25.06.2013
8	15.05.2015	9.933.333		Pagesë për ekzekutimin e vendimit nr. (***), datë 25.06.2013
9	15.05.2015	3.000.000		Pagesë për ekzekutimin e vendimit nr. (***), datë 25.06.2013
10	18.05.2015		7.500.000	Transferuar në llogarinë e H. P.
11	18.05.2015		5.700.000	Vendosur bono thesari

Nga analiza financiare e pasqyruar në tabelën e mësipërme, Komisionit i rezultoi se:

Likuiditetet që kishin si burim:

- Vendimin nr. 129, datë 22.02.2012, të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza e Madhe e Tiranës” (1.385.719 lekë, më datë 25.04.2012), si dhe
- Të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit nr. (***), datë 25.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. (***), datë 20.10.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit (në shumat: 9.933.333 lekë dhe 3.000.000 lekë më datë 15.05.2015), të cilat përjashtohen automatikisht, pasi janë të ardhura dy vite pas regjistrimit të pasurisë (shitesës) në ZVRPP.

Kishin destinacion të konfirmuar të përdorimit: blerjen e apartamentit në: “(***), p. (***), sh. (***), kati (***), ap. (***), Qerret, Kavajë, me sip. (***) m², regjistruar në ZVRPP Kavajë si pasuria nr. (***), ZK (***), vol. (***), fq. (***), si dhe depozitë bono thesari.

Sipas analizës financiare të kryer nga Komisioni mbi llogaritë bankare të personave të tjerë të lidhur, z. H. P. dhe znj. L. P., u konstatua se nuk justifikonin me burime të ligjshme kostot për ndërtimin e shtesës së katit në apartamentin në Rr. “(****)”, p. (***), sh. (***), ap. (****) (kati (****)), si dhe rikonstruksionin e tij, pasi nuk vërtetohej se kishin shpenzuar nga të ardhurat dhe kursimet e tyre për këtë ndërtim.

2.2 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë rezultuan dyshime të arsyeshme për:

- Fshehje e pasurisë së paluajtshme, në përdorim (të ndërtimit shtesë kati e përshtatur si njësi banimi e integruar), në Deklaratën-Vetting, në Deklaratat e Pasurisë dhe Interesave në vitet 2013 - 2016, si dhe në deklaratimet, shpjegimet e dhëna në rrugë postare elektronike pranë Komisionit.
- Deklarim i rremë lidhur me burimin e ligjshëm financiar të realizimit të ndërtimit shtesë, pasi nuk rezulton që personat e tjerë të lidhur, z. H. dhe znj. L. P., të kenë realizuar ndërtimin shtesë me burime financiare të destinuar për këtë qëllim.
- Mungesë burimesh financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, për të justifikuar ndërtimin e pasurisë në përdorim, shtesës së katit.
- Kryerjen nga ana subjektit të veprimeve juridike fiktive, lidhur me dhurimin me kusht të apartamentit me sipërfaqe 50 m², në Rr. “(****)”, drejt personave të tjerë të lidhur (vjehtëri/vjehtëra), me qëllim dhënien e imazhit të rremë të zhveshjes së tij nga pronësia e, për pasojë, shkarkimin nga përgjegjësitë përkatëse të veprimeve të mëtejshme, pasi nga deklaratimet e subjektit rezultoi se ai ka qenë dhe vazhdon të jetë i vetmi posedues efektiv në këtë pasuri. Veprimet e subjektit cenojnë rëndë pastërtinë e figurës dhe etikës së magjistratit.

2.3 Ndërsa subjekti i rivlerësimit, më datë 05.06.2018, dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij⁸, po ashtu edhe në seancën dëgjimore të datës 14.06.2018. Ndër të tjera, për këtë pasuri, subjekti është shprehur se:

1. U përmbahet deklaratimeve dhe sqarimeve të bëra në lidhje me dhurimin e apartamentit, shtesës së bërë, si dhe shpenzimeve të kryera.
2. Paraqiti një deklaratë noteriale nr. (****) rep., nr. (****) kol., të datës 31.05.2018, të lëshuar dhe nënshkruar nga shtetasit H. P. dhe L. P., të cilët deklarorin se shtesa ishte bërë nga ana e tyre dhe shpenzimet ishin bërë nga të ardhurat dhe kursimet e tyre, por nuk kishin ruajtur faturat.
3. Burimet e të ardhurave të shtetasit H. P. dhe L. P., ishin ato të deklaruara më parë⁹, të cilat Komisioni i kishte verifikuar gjatë kryerjes së analizës financiare, të shoqëruar me

⁸Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje.

⁹Të ardhura nga qiraja e marrë sipas kontratës me nr. (****), datë 12.02.2007, me Njësinë Bashkiake Nr. (****), Tiranë.

Si burim të ardhurash përmendim edhe të ardhurat e siguruar nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. (****), datë 25.06.2013, e lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit nr. (****), datë 20.10.2014, vendim i ekzekutuar plotësisht).

dokumentacionin, si dhe një hua të marrë në shumën 20 mijë euro, nga kompania “(***)”, datë 18.07.2006, sipas mandatarkëtimit (***), datë 18.07.2006.

4. Kontrata e dhurimit kishte fuqi të plotë juridike dhe sillte pasoja juridike. Objekti i ndërtuar ishte legalizuar dhe regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në emër të pronarëve, të cilët mund ta disponojnë, në çdo kohë, së bashku me apartamentin e marrë dhuratë.
5. Shtetasit H. dhe L. P. nuk kishin qenë dhe nuk ishin subjekte deklarimi të pasurisë dhe, për rrjedhojë, nuk kishin detyrim ligjor deklarimin e pasurive në emër të tyre, të ardhurat e shpenzimet.
6. Deklarimi nga ana e tij i adresës së kësaj pasurie, në interpretim të Kodit Civil, kishte të njëjtat efekte juridike me përdorimin.
7. Përdorimi i shtesës së katit nga ana e tij ishte i lidhur edhe me marrëdhëniet e tij shumë të mira me prindërit e bashkëshortes. Kjo pasuri, si në emrin e tij apo në emër të prindërve të bashkëshortes, ishte e njëjta gjë, pasi ishte pjesë e pronës së familjes.

2.4 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, mbështetur në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike, sipas pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, provat shkresore të administruara, sipas neneve 49 dhe 50 të po këtij ligji, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, arsyeton se:

Në lidhje me ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie, shtesë kati, ka fshehje të pasurisë në përdorim, deklaram të rremë, si dhe mungesë të të ardhurave të mjaftueshme të ligjshme për vitin 2007, provuar kjo me:

- Deklarimet e subjektit të rivlerësimit, datë 14.01.2016, pranë ILDKPKI-së, *se e dhuroi apartamentin në vitin 2012 të vjehrrit e vjehrra për të marrë kredi*, por në këtë apartament kishte banuar dhe banon vetë dhe familja e tij, pasi kredia nuk u mor, e më pas apartamenti ngeli në emër të personave të tjerë të lidhur, shtetasve H. dhe L. P. Deklarimet e subjektit pranë Komisionit, më datë 05.03.2018, se banesa në apartamentin nr. (***) ka qenë e subjektit gjatë gjithë kohës, me shkëputje të vogla ditore, për shkak të punimeve.
- Të ardhurat e shtetasve H. dhe L. P., të krijuara me burime të ligjshme, **kanë destinacion të përcaktuar, të ndryshëm nga ai i financimit për ndërtimin e shtesës.**
- Deklarimin e subjektit se: *...adresa zyrtare dhe e banimit e vjehrrit dhe vjehrrës është Rr. “(***)”; kati i (***) është i lidhur me katin e pestë me shkallë të brendshme, dhe aktualisht banon ai me familjen e tij. Mobilimi i katit të gjashtë ishte bërë nga ana e bashkëshortes përpara martesë, në vitin 2010. Vlerën e objekteve nuk mund ta përcaktonte në mënyrë të saktë. “Në lidhje me mobilimin e tyre, sqaroj se pjesa kryesore është bërë nga ana e familjes së bashkëshortes përpara martesë. Faturat në lidhje me blerjet e tyre nuk janë ruajtur”.*

Shënim: (Prona e shpronësuar në vitin 2011-2002 për qëllime të ndërtimit të Unazës së Madhe, Tiranë, është fituar nga ana e nënës së bashkëshortes sime me ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronave).

- Nënshkrimet e formularëve aplikues, duke u angazhuar personalisht dhe vetëdeklaruar si person i autorizuar për formalitetet me ALUIZNI-n “Tirana 2” dhe ZVRPP Tiranë, pa një akt përfaqësimi nga bashkëshortët P.

Referuar deklaramëve përmes postës elektronike, si dhe në bazë të të dhënave të siguruara nga hetimi, **rezultoi se kushti i dhurimit nuk është përmbushur**, pasi subjekti i rivlerësimit, edhe pas nënshkrimit të kontratës së dhurimit me kusht (neni 2, 3 i kontratës, si dhe neni 794 i Kodit Civil), ka qenë dhe vijon të jetë *sunduesi efektiv* mbi apartamentin objekt dhurimi.

Referuar deklaramëve pranë ILDKPKI-së dhe Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka pranuar që kontrata e dhurimit të apartamentit kishte tjetër qëllim, atë të rritjes së pasurisë së bashkëshortëve P., që këta të përfitonin kredi për strehim, duke dhuruar këtë pasuri për shkaqe tërësisht subjektive që lidhen vetëm me dhuruesin, ndryshe nga qëllimi ligjor i lidhjes së një kontrate dhurimi, siç parashikohet edhe në nenin 761 të Kodit Civil”: *“Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat ajo i pranon”*.

Argumenti i mësipërm mbështetet edhe në faktin se qëllimi i dhurimit të pasurisë për marrjen e kredisë nuk u përmbush, si dhe:

Arsyet e paraqitura në deklaramet e subjektit, pranë ILDKPI-së, *“se kredia nuk u mor për arsye shëndetësore”*, si dhe ato të paraqitura pranë Komisionit *“se u kërkua për riparimin e një shtëpie tjetër të vjetër”*, bien **në kundërshtim me:**

1. Deklarimin që bashkëshortët P. kanë bërë përmes deklaratës noteriale nr. (***) , datë 31.05.2018, se kredia nuk u mor, se ishte e papërbalueshme financiarisht nga ana e tyre, si dhe me rrethanat e konstatuara e të provuara nga situata financiare e këtyre personave (vjeherri, vjehrra), nga ku gjendja e tyre pasurore ka treguar se kishin pasuri dhe njëkohësisht, në këtë vit, i kanë dhuruar subjektit shumën prej 5 mijë eurosh, të cilën e përdori për mbyllje të kredisë.

2. Deklarimin e subjektit të rivlerësimit në datën 16.03.2018, se punimet kanë nisur në vjeshtën e vitit 2012, ndërkohë që dhurimi ishte bërë në fund të nëntorit (me kontratën nr. (***) , datë 21.11.2012), nga ku rezulton se punimet kanë nisur në kohën kur subjekti ka qenë pronar i apartamentit të dhuruar.

Nuk qëndron as pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se në kushtet që ka deklaruar të njëjtën adresë, ka ezauruar edhe deklaramin e pasurisë në përdorim. Ky pretendim i tij bie në kundërshtim me:

- *Nenin D të Aneksit të Kushtetutës, pika 1, i cili parashikon se subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.*
- *Nenin 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe shtojcën nr. 2, “Formulari i deklaramit të pasurisë”, të cilët parashikojnë se: Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarami dhe kontrolli i pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.*
- *Nenin 3, pika 11, të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se “pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas*

parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

Pretendimi i subjektit në seancën dëgjimore se përdorimi i shtesës së katit nga ana e tij ishte i lidhur edhe me marrëdhëniet shumë të mira me prindërit e bashkëshortes, bie në kundërshtim me faktet e konstatuara si pasuri në përdorim nga ana e tij, kjo e padeklaruar; me deklaratimet e dhëna nga ai vetë, se ka qenë e vijon të jetë posedues i saj. Nga ana tjetër, ky pretendim çmohet i papranueshëm për funksionin e tij në raport me detyrimin e përgjegjësishëm që mbart si subjekt i ligjit për deklarimin e pasurisë.

Dokumenti i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, deklarata noteriale e datës 30.05.2018, e shtetasve H. dhe L. P., është i pambështetur me prova dhe në kundërshtim me faktet e konstatuara dhe të vërtetuara me materialet shkresore të siguruar nga subjektet bankare, nga DRSSH Tiranë, nga ZVRPP Tiranë, sa i takon gjendjes pasurore (të paluajtshme dhe monetare) të bashkëshortëve P., nevojës së tyre për strehim, nevojës së tyre për financim të riparimit të banesës me kredi bankare, krahasuar me faktin e dhurimit të shumave që i bëjnë pak ditë më parë subjektit të rivlerësimit, me të cilat, ky i fundit likuidon tërësisht dhe para kohe kredinë prej 28.000 eurosh.

Lidhur me burimet e ligjshme të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, z. H. dhe znj. L. P., dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ, si dhe ai i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, nuk justifikojnë me burime të ligjshme kostot për ndërtimin e shtesës së katit, si dhe rikonstruksionin e tij, pasi nuk vërtetohet se kanë shpenzuar nga të ardhurat dhe kursimet e tyre të destinuara për këtë ndërtim. Nga ana tjetër, materialet shkresore të ardhura nga subjektet bankare vërtetojnë gjendjen e tyre pasurore (monetare) në periudhat para dhe pas nënshkrimit të kontratës së dhurimit, nga të cilat rezultoi se kishin pasuri të paluajtshme të mjaftueshme dhe financa të mjaftueshme për të mos qenë të detyruar që të nënshkruanin një kontratë dhurimi si pranues të saj, për të rritur fiktivisht gjendjen e pasurisë së paluajtshme, për ta vendosur si garanci hipotekore për kredinë.

Sa më lart, trupi gjykues vlerëson se jemi para një simulimi (maskim) që subjekti i rivlerësimit ka kryer në bashkëpunim me personat e tjerë të lidhur, për të fshehur ndërtimin pa leje sipër apartamentit. Për të garantuar marrjen e një kredie për strehim, nuk ishte e nevojshme që kredimarrësi të kishte domosdoshmërisht në pronësi të vet pasuri të paluajtshme, sa kohë që ligji parashikon mundësinë që persona të tretë mund të jenë garantorë të kredisë me pasuritë dhe të ardhurat e tyre.

Trupi gjykues çmon se dhurimi nuk u realizua asnjëherë (si për efekt të ligjit – *ipso jure*, ashtu edhe për efekt kushtit të kontratës së dhurimit – *ipso acta*, apo edhe si çështje faktike – *ipso facta*) dorëzimi i sendit nuk u realizua asnjëherë, për pasojë dhurimi nuk u bë asnjëherë i efektshëm dhe real, sikurse parashikohet nga nenet 2 dhe 3 të kontratës së dhurimit, neni 764, paragrafi 4, i Kodit Civil, i cili parashikon se: “...Kontrata e dhurimit quhet e lidhur nga çasti i dorëzimit të sendit”. Lidhur me burimet e ligjshme të subjektit të rivlerësimit për ndërtimin e shtesës, Komisionit i rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar shpenzimet për ndërtimin e shtesës së katit, si dhe ka mungesë dokumentacioni ligjor e financiar për të provuar përdorimin e tyre.

Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka kryer:

- **Fshehje të pasurisë së paluajtshme, në përdorim** (të ndërtimit shtesë kati, e përshtatur si njësi banimi e integruar).
- **Deklarim të rremë, lidhur me përdorimin e burimeve të ligjshme** për realizimin e ndërtimit të shtesës së katit.
- **Ka ndërmarre veprime juridike fiktive**, lidhur me dhurimin me kusht të apartamentit me sipërfaqe 50 m², në Rr. “(***), drejt personave të tjerë të lidhur (vjehtë/vjehër), me qëllim dhënien e imazhit të rremë të zhveshjes nga pronësia e për pasojë, shkarkimin nga përgjegjësitë përkatëse të veprimeve të mëtejshme, pasi nga provat dhe faktet rezultoi se ka qenë e vijon të jetë i vetmi posedues efektiv në këtë pasuri. Veprimet e tij cenojnë rëndë pastërtinë e figurës dhe etikës së magjistratit.

3. Dhurime monetare dhe materiale nga prindër dhe të afërm të tjerë (kushërinj me qëndrim në emigrim), si më poshtë:

- **Dhurim** në prill të vitit 2012, në shumën 5.000 euro, nga prindërit e bashkëshortes.
- **Burimi i krijimit:** e ardhur e krijuar nga shuma e marrë nga dhuruesit me Vendim të Këshillit të Ministrave, për shpronësimin publik (VKM nr.129, datë 22.02.2012).
- **Dhurime** në shumën 1.200 euro dhe 25.000 lekë të dhuruara nga të afërmit;
- **Hua** në shumën 300.000 lekë të dhëna nga motra dhe nëna në vitin 2012.

Burimi i krijimit: e ardhur nga kursimet familjare në vite, në shumën 260.270 lekë, nga Banka e Tiranës, vërtetuar sipas dokumentit bankar, e pjesa tjetër *cash*.

Lidhur me dhurimet, ILDKPKI-ja ka konkluduar se nga ana e subjektit deklarues ka mungesë dokumentacioni ligjor për dhuratat totale, rreth 6.200 euro.

Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e të ardhurave të realizuara nga dhurimet dhe huaja

3.1 Komisioni, për vërtetimin e faktit të burimit të të ardhurave verifikoi përmes institucioneve bankare likuiditetet e personave dhurues dhe huadhënës, sipas se cilave nuk rezultoi të kishte transaksione (transfertë) me përfitues subjektin e rivlerësimit.

Në referim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” (të ndryshuar), në nenin 4 të tij, germa “f”, deklarohen:

“f) Dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. Nuk deklarohen dhurata ose trajtimet preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10.000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi”.

3.2 Komisionit i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë rezultuan dyshime të arsyeshme se:

Në deklaratat periodike dhe në deklaratën e datës 24.01.2017 rezultonte mungesë dokumentacioni ligjor për:

- shumën 5000 euro të dhuruar nga prindërit e bashkëshortes;
- shumën 1200 euro dhe 25.000 lekë të dhuruara nga të afërmit;
- shumën 300.000 lekë të dhënë borxh nga motra dhe nëna.

3.3 Ndërsa subjekti i rivlerësimit, më datë 05.06.2018, dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij¹⁰, po ashtu edhe në seancën dëgjimore të datës 14.06.2018. Ndër të tjera, për konstatimet e Komisionit mbi dhurimet dhe huan, subjekti është shprehur se:

- Shuma e dhuruar prej 5.000 eurosh, në muajin prill 2012, nga vjehrra L. P., e përdorur për shlyerje të pjesshme të kredisë, ishte e ardhur nga pjesa e shumës së marrë me vendim të Këshillit të Ministrave për shpronësim publik nr. 129, datë 22.02.2012, të shoqëruar me dokumentin bankar të llogarisë së shtetases L. P., si dhe deklaratën noteriale nr. (***) rep., nr. (***)kol., të datës 31.05.2018.
- Huan në shumën 300.000 (treqind mijë) lekë ia kishte dhënë borxh motra dhe nëna në vitin 2012, vërtetuar sipas dokumentit bankar të Bankës së Tiranës, datë 11.01.2016, dhe pjesa tjetër *cash*, si dhe deklaratë noteriale nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 04.06.2018, përmes së cilës motra e tij dhe nëna, znj. Sh. T., konfirmonin dhënien e huas.
- Për dhurimin e shumës prej 1200 eurosh dhe 25.000 lekësh, të dhuruara nga të afërmit, ka shpjeguar se të ardhurat janë marrë gjatë viteve përpara muajit tetor 2004, në vlera (më të vogla sa shuma e kërkuar nga ligji) dhe kohë të ndryshme, nga persona që kanë qenë emigrantë në Itali e Greqi.

3.4 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, arsyeton se:

1. Dokumentacioni mbi transaksionet bankare të paraqitura si prova nga subjekti i rivlerësimit pasqyrojnë veprime të dhuruesit e huadhënësve, të cilët kanë kryer tërheqje *cash*, pa përcaktuar qëllimin e tërheqjes së tyre (*përshkrim dhurim apo hua*), për pasojë nuk vërtetojnë se këto shuma kanë si përfitues subjektin e rivlerësimit.
2. Deklarata noteriale nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 31.05.2018, si dhe deklarata noteriale nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 04.06.2018, të dhurueses dhe huadhënësve, nuk përputhen në kohë me detyrimin e subjektit për t'i deklaruar si burim të ardhurash.

Trupi gjykues, duke shqyrtuar e analizuar provat e sjella nga subjekti, vlerëson se shpjegimet e tij nuk janë bindëse për të justifikuar se të ardhurat nga dhurimet dhe huaja kanë pasur si përfitues subjektin e rivlerësimit.

Si konkluzion, në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, trupi gjykues, pasi konstatoi:

- i) Deklarim të rremë, për kontratën e shitblerjes së pasurisë nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 07.06.2007, si dhe për çmimin e blerjes së këtij apartamenti.
- ii) Mungesë të ardhurash të ligjshme të mjaftueshme (*të ardhura nga paga dhe kredia*) për blerjen e apartamentit me çmim 40.000 euro, në raport me shpenzimet e deklaruara¹¹

¹⁰Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje.

¹¹ Në shpjegimet e pas-barrës së provës, por edhe në seance dëgjimore, subjekti deklaroi se shpenzimet për ristrukturim të apartamentit dhe arredim kanë qenë në shumën 13 mijë euro.

- nga subjekti për rikonstrukcionin e apartamentit dhe atyre jetike, duke rezultuar kështu me mungesë burimi të ardhurash në shumën minus 1.517.924 lekë për vitin 2007.
- iii) Nuk provoi me dokumentacion ligjor shpenzimet e vlerës prej 13 mijë eurosh, për ristrukturim e mobilim të apartamentit.
 - iv) Mosdeklarim likuiditeti të gjendjes *cash*, si rikuperim i shumës 12 mijë euro në deklaratën periodike të viti 2007.
 - v) Ndërmarrjen nga ana e tij të veprimeve fiktive në ZVRPP Tiranë, sa i takonte regjistrimit të kontratës së fitimit të pronësisë, si dhe të çmimit të vërtetë të transaksionit.
 - vi) Fshehje të pasurisë së paluajtshme, në përdorim (të ndërtimit shtesë kati, e përshtatur si njësi banimi e integruar).
 - vii) Deklarim të rremë lidhur me përdorimin e burimeve të ligjshme për realizmin e ndërtimit të shtesës së katit.
 - viii) Ndërmarrjen e veprime juridike fiktive lidhur me dhurimin me kusht të apartamentit me sipërfaqe 50 m², në Rr. “(***)”, drejt personave të tjerë të lidhur (vjehtë/vjehtëra).

Konkludon se: Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka dhënë shpjegime bindëse, referuar pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe parashikimeve të nenit D, pika 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

B. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS

Kontrolli i figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. (***) prot., datë 27.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i deklasifikuar me vendim të KDZH, nr. (***), datë 08.01.2018, për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Trenova.

Komisioni, si organ i pavarur dhe i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, lidhur me këtë kriter nuk i rezultoi ndonjë element dyshues mbi ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016.

C. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KRITERIT ETIKO-PROFESIONAL

Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme, nr. (***) prot., datë 11.01.2018.
- Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Prokuroria e Përgjithshme, në vlerësimin e saj është bazuar në: Formularin e vetëdeklarimit, 3 dokumente ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, 5 dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë. Ky institucion, në përshkrimin e 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, ka konstatuar:

1. Aftësitë profesionale

- a) Njohuritë ligjore - Nga vlerësimet e punës së subjektit Gentian Trenova për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, ka rezultuar se subjekti Gentian Trenova është vlerësuar *“shumë mirë”* për aftësitë profesionale të treguara prej tij, pasi detyrat e ngarkuara i ka kryer me cilësi. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 16.11.2017 në Prokurorinë e Rrethit Tiranë për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, ka rezultuar se subjekti Gentian Trenova shfaq aftësi në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Ai përdor arsyetim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e tij në rastin konkret.
- b) Arsyetimi ligjor- Nga vlerësimet e punës së subjektit Gentian Trenova për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, është vlerësuar *“shumë mirë”* për aftësitë profesionale të treguara prej tij, pasi detyrat e ngarkuara i ka kryer me cilësi. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 16.11.2017 në Prokurorinë e Përgjithshme për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, ka rezultuar se subjekti ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej tij kanë shtjellim të kuptueshëm. Subjekti organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregon kujdes që konkluzionet e vendimmarrjes së tij të jenë të drejta dhe të bazuara në legjislacionin procedural e material penal.

2. Aftësitë organizative

- a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë- Nga vlerësimet e punës së subjektit Gentian Trenova për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, është vlerësuar *“shumë mirë”* për aftësitë profesionale të treguara prej tij, pasi detyrat e ngarkuara i ka kryer, me ngarkesë pune voluminoze, me cilësi dhe shpejtësi. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 17.11.2017 në Prokurorinë e Krimeve të Rënda për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, rezulton se afatet kohore të zgjidhjes së praktikave që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse, si dhe subjekti ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara me shpejtësi, pa dëmtuar cilësinë e vendimmarrjes.
- b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore - Nga vlerësimet e punës së subjektit Gentian Trenova për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar *“shumë mirë”* për aftësitë organizative të treguara prej tij, pasi ka përballuar ngarkesë pune voluminoze me cilësi dhe shpejtësi. Nga gjetjet në procedimet penale të përzgjedhura në shortin e zhvilluar lidhur me subjektin rezulton se në të gjitha procedimet penale janë kryer në çdo rast procedurat e njoftimit të akteve të prokurorit për palët pjesëmarrëse dhe, po kështu, për këto procedura nuk ka pasur kontestime apo ankesa prej tyre.
- c) Aftësia për të administruar dosjet - Nga gjetjet në procedimet penale të përzgjedhura në shortin e zhvilluar lidhur me subjektin rezulton se prokurori, subjekt kontrolli, shfaq aftësi për të administruar dosjet. Rezulton se, megjithëse një pjesë e tyre kanë qenë procedime të vështira për hetim dhe janë kryer një numër i madh veprimesh hetimore, nuk është konstatuar që në

ndonjë rast të ketë pasur nxjerrje të sekretit hetimor apo të akteve e hetimeve paraprake që mund të dëmtonin hetimin. Dosjet e prokurorit Trenova rezultojnë që përmbajnë të gjitha aktet e hetimeve paraprake, të renditura e të listuara në mënyrën e saktë me përcaktimet ligjore.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

- a) Etika në punë- Në lidhje me vlerësimin e etikës në punë, nga vlerësimet e punës së subjektit Gentian Trenova për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, Trenova është vlerësuar *“shumë mirë”* për etikën profesionale.
- b) Integriteti- Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të këtij raporti, për subjektin Gentian Trenova nuk rezultojnë të dhëna apo elemente për të konkluduar rreth cenimit të integritetit të tij.
- c) Paanësia- Në lidhje me vlerësimin e paanësisë për subjektin Gentian Trenova, për periudhën objekt vlerësimi, nuk rezulton të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar apo të jenë diskutuar cenimi i të drejtave të pjesëmarrësve në proces apo të grupeve shoqërore vulnerabile.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

- a) Aftësitë e komunikimit-Në lidhje me vlerësimin e aftësive komunikuese, nga vlerësimet e punës për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, z. Trenova është vlerësuar *“shumë mirë”* për aftësitë e komunikimit.
- b) Aftësia për të bashkëpunuar- Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit Gentian Trenova për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, është vlerësuar *“shumë mirë”* për aftësitë e bashkëpunimit.
- c) Gatishmëria për t’u angazhuar- Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, për periudhën objekt vlerësimi, subjekti Gentian Trenova rezulton të jetë angazhuar në një sërë aktivitete profesionale.

Rivlerësimi i kriterit etiko-profesional nga Komisioni

Trupi gjykues, lidhur me këtë kriter, ka hetuar në mënyrë të pavarur¹² nga institucioni i Prokurorisë së Përgjithshme mbi dosjet e përzgjedhura me short për çështjet e mëposhtme:

Çështja nr. 1 - “Vendimi për mosfillimin e procedimit penal, datë 30.03.2015, për hetim pasuror mbi pasurinë në aktet e referuara me nr. (***) , të vitit 2015, të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, për shtetasin V. L., të hetimit të procedimit penal nr. (***) , të vitit 2015”.

Grupi i Punës i Prokurorisë ka konstatuar se:

“Në pjesën arsyetuese, subjekti i rivlerësimit arsyeton që nuk ka pasuri qartësisht të pajustificuara në emër të z. V. L., të cilat do ta bënin atë përgjegjës sipas ligjit nr. 10192, datë 03.10.2010, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Vendimi në përgjithësi është strukturuar mirë dhe është i argumentuar nga ana ligjore.”

¹² Në referim të dispozitave ligjore kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, Institucionet e Rivlerësimit, janë institucione të pavarura dhe të paanshme, në kryerjen e procesit të rivlerësimit, që nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, siç përcaktohet edhe në vendimet e Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2 dhe 78 të vitit 2017.

Shqyrtimi i materialeve të dosjes penale nga trupi gjykues

Ky procedim për hetim pasuror ishte regjistruar bazuar në materialin referues të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, më datë 22.09.2014. Me vendimin e datës 30.03.2015, ishte vendosur mosfillimi i hetimit pasuror, pasi nga shqyrtimi i të dhënave të mbledhura, nuk kishte rezultuar që shtetasi V. L., ose personi i lidhur me të, të ketë në pronësi ndonjë pasuri tërësisht të pajustificuar, e cila mund të konsiderohet si e ardhur nga veprimtari të paligjshme.

Sipas dokumenteve të dosjes së çështjes vihet re që, në shkresën e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastër, Seksioni i Hetimit të Aseteve Kriminale, për referimin e veprës penale datë 30.04.2013, evidentohet shkresa nr. (***) prot., datë 27.05.2007, e Drejtorisë së Luftës Kundër Krimin të Organizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas së cilës, shtetasi me inicialet V. L. (identifikuar me të dhënat personale përkatëse) ishte ndaluar nga Policia e Janinës në Greqi, për shkak se i janë sekuestruar 117 kg e 700 gr kanabis sativa, si dhe një pistoletë e tipit “Tokaref”.

Seksioni i Hetimit të Aseteve Kriminale pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastër ka nisur verifikimin e të gjitha pasurive të këtij shtetasi, si dhe të personave të lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Në bazë të të dhënave të siguruara nëpërmjet verifikimit të kryer (ZVRPP-ve të rretheve të ndryshme dhe agjenci rajonale të ALUIZNI-t), ky organ procedues ka evidentuar pasuritë e regjistruara në emër të shtetasit V. L., për të cilat shprehet se janë përfitime pasurore nga veprimtaria kriminale e trafikimit të lëndëve narkotike. Gjithashtu, në referimin e veprës penale konstatohet se: “*Nga burime konfidenciale ky shtetas disponon prona të tjera të paregjistruara, si dhe llogari bankare që rrjedhin nga veprimtaria kriminale, të depozituara në banka të ndryshme që operojnë në shtetin shqiptar.*” Bazuar në të dhënat e siguruara si më sipër, është regjistruar fillimi i hetimit pasuror në ngarkim të shtetasit V. L., dhe familjarëve të tij; lëshimin e urdhrave për hetimin e mjeteve financiare, të pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare dhe profesionale. Në përfundim të verifikimit dhe hetimit pasuror paraprak, me shkresën përcjellëse nr. (***) prot., datë 30.04.2013, Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastër ka dërguar materialet procedurale në Prokurorinë për Krimet e Rënda, ku subjekti është caktuar prokuror i çështjes. Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastër, sipas urdhrit të subjektit, datë 29.09.2014, “për verifikimin e të gjitha pasurive të mundshme të padeklaruara në posedim të shtetasit V. L., pasi nga informacioni policor dyshohet se shtetasi V. L. ka pasuri të paluajtshme të paregjistruara”, ka dërguar materialet procedurale, shkresat nr. (***) prot., datë 18.03.2015 dhe nr. (***) prot., datë 14.11.2014, të ALUIZNI-t Gjirokastër dhe foto të shtëpisë së V. L., në fshat, e cila është ndërtuar pa dokumentacionin ligjor përkatës.

Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, datë 14.05.2018, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit dhe, më datë 28.05.2018, njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues kishte arritur në përfundimin se provat e administruara në lidhje me kriterin profesional kishin nivelin e provueshmërisë. Trupi gjykues i ka dërguar subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit kryesisht, duke e njoftuar se, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, ai ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën **për sa më poshtë:**

- Me vendimin e datës 30.03.2015, subjekti i rivlerësimit kishte vendosur mosfillimin e hetimit pasuror, sepse pasuritë e regjistruara ishin fituar përpara vitit 2006, ndërsa shtëpia e banimit në fshat referohet si ndërtesë për qëllime *banimi*.

Referuar ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, nenit 8 të tij, parashikohet se:

“.....Prokurori kryen veprime vetë dhe nëpërmjet Policisë Gjyqësore për hetimin e mjeteve financiare, të pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare dhe profesionale, mënyrës së jetesës, si dhe të burimeve të të ardhurave të personave, subjekte të zbatimit të këtij ligji”.

Nga aktet e administruara në dosjen penale, si dhe në vendimin e mosfillimit të hetimit pasuror konstatohet se mungonte:

- a. Verifikimi i plotë i pasurive, asetëve dhe likuiditeteve në bankë të shtetasit në hetim.
- b. Verifikimi i plotë i të gjithë historikut të aktivitetit tregtar, si dhe i pasjes ose mospasjes së pjesëve sociale (kuota/aksione) në Regjistrin Tregtar, duke qenë se nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë ka vetëm një përgjigje të shkurtër, që evidenton vetëm faktin se aktiviteti i shtetasit V. L., në kuadër të shoqërisë “(***)” sh.p.k., me NIPT, (***) (fillimi i aktivitetit, datë 13.05.2010), në atë moment është me status pasiv.
- c. Verifikimi i plotë i të gjitha transaksioneve të mundshme me veprime noteriale, për investime në pasuri të paluajtshme apo në veprimtari të tjera, duke marrë informacion nga Ministria e Drejtësisë për të dhënat në Regjistrin Noterial Shqiptar, bazuar në VKM-në nr. 304, datë 21.05.2014, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit noterial shqiptar, Regjistri Noterial Shqiptar”.
- ç. Verifikimi i plotë i burimeve të të ardhurave dhe mënyrën së jetesës të shtetasit V.L., dhe familjarëve të tij.
- d. Nuk rezultuan arsyetimi i plotë, analitik dhe logjik në vendim i të gjitha të dhënave që rezultuan nga veprimet procedurale të hetimit pasuror paraprak nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë.

Sipas dispozitave të nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 84/2016: “Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”.

Pika 2 e nenit 73 të nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përcakton që: “Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën”.

2.3 Ndërsa subjekti i rivlerësimit, më datë 05.06.2018, dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij¹³, po ashtu edhe në seancën dëgjimore të datës 14.06.2018. Në përgjigje edhe të pyetjeve të bëra, ndër të tjera, për rezultatet e trupit gjykues për vlerësimin profesional është shprehur se:

1. Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë, me shkresën nr. (***) prot., datë 22.09.2014, kishte përcjellë material me qëllim fillimin e procedurës së hetimit pasuror ndaj shtetasit V.L., i cili në vitin 2006 ishte akuzuar nga autoritetet greke se kishte shkelur ligjin mbi narkotikët dhe konkretisht për një sasi kanabis sativa prej 117 kg, dhe në vitin 2008 ishte akuzuar nga autoritetet e shtetit grek për shkelje të ligjit për narkotikët në lidhje më një sasi prej 91 kg kanabis sativa.

¹³Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje.

2. Nga informacioni policor ishte evidentuar veprimtaria kriminale e shtetasit V. L. që në vitin 2006. Nga ana e policisë dyshohej se shtetasi V.L. kishte pasuri të paluajtshme të peregjistruara.
3. Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë kishte dërguar informacion lidhur me një pasuri të paluajtshme/ndërtesë njëkatëshe të peregjistruar në një zonë rurale.
4. Në lidhje me këtë vendimmarrje, në ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009, për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë në fjalë, nuk janë të parashikuara qartë procedurat e fillimit të hetimit pasuror.
5. Përveç se kërkesave për dyshime në veprimtari në fushën e krimeve sipas nenit 3 të ligjit, duhej që nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë të referoheshin të dhëna të mjaftueshme, të detajuara, në lidhje me pasuritë dhe jo të supozuara. E vetmja e dhënë e sjellë nga ana e policisë kishte qenë një shtëpi e vogël, e cila në një vlerësim paraprak kishte një vlerë shumë të ulët. Gjithashtu, nga informacioni referues kjo pasuri nuk rezultonte të ishte vënë gjatë apo pas veprimtarisë kriminale siç kërkohej nga ligji i kohës.
6. Qëllimi i ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, nuk ka pasur për kuptim hetimin e çdo rasti kur konstatohet njëra nga veprat e parashikuara në nenin 3 të ligjit. Por, ky ligj kërkonte që hetimi të bazohej edhe kur nga hetimet e bëra kishte dyshime të besueshme dhe jo supozime, për pasuri të vendosura gjatë veprimtarisë kriminale. Në të kundërt, ndjekja e një procedure tjetër formale do të sillte një ngarkesë të madhe (duke u bazuar në statistikën si dhe në udhëzimin për procedurën e hetimit pasuror të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm për çështjet e hetimit pasuror të referuara nga drejtoritë e policisë, nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, dhe për mënyrën se si do të procedohej në rastet e referimit nga ana e Prokurorisë së Krimeve të Rënda), e cila do të krijonte kolaps në hetimin e pasurive të krimit të organizuar dhe do bënte një hetim joefektiv dhe joproduktiv në rastet e tjera ku kanë rezultuar pasuri të dyshuara si të vendosura nga veprimtaria kriminale.
7. Vendimi për mosfillimin e hetimit pasuror ishte plotësisht i ligjshëm, i arsyeshëm dhe i miratuar edhe nga drejtuesi i Prokurorisë, i cili ka konstatuar rregullsinë e vendimmarrjes dhe nuk e ka gjetur të arsyeshëm ndryshimin e vendimit dhe kryerjen e veprimeve verifikuese.

Rivlerësimi i trupit gjykues

Bazuar në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, neni 8 i tij, ku parashikohet se: “...Prokurori kryen veprime vetë dhe nëpërmjet Policisë Gjyqësore për hetimin e mjeteve financiare, të pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare dhe profesionale, mënyrës së jetesës, si dhe të burimeve të të ardhurave të personave, subjekte të zbatimit të këtij ligji. ”, trupi gjykues, në vlerësim të konstatimeve të kryera, pasi analizoi edhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, arsyeton:

Për pikën 1 dhe për pikën 2 të shpjegimeve - Subjekti i rivlerësimit nuk shpreh asnjë kundërshtim mbi konstatimet e kryera nga Komisioni.

Për pikën 3 të shpjegimeve - Ndryshe nga sa shpjegon subjekti i rivlerësimit, Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë referonte me informacion ekzistencën e më shumë se një pasurie të paluajtshme.

Sipas dokumenteve të dosjes së çështjes, Seksioni i Hetimit të Aseteve Kriminale pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë nisi verifikimin e të gjitha pasurive të këtij shtetasi, si dhe të personave të lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Në bazë të të dhënave të siguruara nëpërmjet verifikimit të kryer (ZVRPP-të e rretheve të ndryshme dhe agjenci rajonale të ALUIZNI-t), ky organ procedues evidenton pasuritë e regjistruara në emër të shtetasit V.L., për të cilat shprehet se janë përfitime pasurore nga veprimtaria kriminale e trafikimit të lëndëve narkotike. Gjithashtu, në referimin e veprës penale konstatohet se: “Nga burime konfidenciale, ky shtetas disponon prona të tjera të paregjistruara, si dhe llogari bankare që rrjedhin nga veprimtaria kriminale, të depozituara në banka të ndryshme që operojnë në shtetin shqiptar.”

Për pikën 4 të shpjegimeve - Subjekti i rivlerësimit shpreh paqartësi procedurale mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Ky ligj është plotësisht i zbatueshëm dhe çdo prokuror e ka të detyrueshëm zbatimin e tij dhe jo shmangien nëpërmjet pretendimit se ligji është i paqartë. Në fakt, ligji në fjalë, për aq sa lidhet hetimi i Komisionit në këtë çështje, i ka të parashikuara qartësisht kriteret dhe rrethanat në të cilat duhet çmuar verifikimi pasuror paraprak dhe më tej regjistrimi i hetimit pasuror, si në aspektin objektiv, ashtu edhe në atë subjektiv.

Në nenin 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *“Ky ligj përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikim”*.

Për pikën 5 të shpjegimeve - Ndryshe nga sa shpjegon subjekti i rivlerësimit, materiali referues i komunikuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë, përmban një sërë veprimesh të verifikimit pasuror paraprak, nga të cilat të mund të vijohej me hetimin pasuror. Nga ana e subjektit të rivlerësimit u kufizua vlera e këtij materiali vetëm në një pjesë të tij, duke përjashtuar për pasojë dhe as analizuar informacionin për asete që ishin të regjistruara në emra të ndryshëm në ZVRPP (të rretheve të ndryshme), si dhe shuma të depozituara nëpër banka të ndryshme të nivelit të dytë. Këto informacione, subjekti i rivlerësimit nuk i vlerëson, si në vendimin e mosfillimit të hetimit pasuror, por ndërkohë rezulton që nuk gjendet asnjë shpjegim i dhënë nga ana e tij edhe pas kalimit të barrës së provës.

Për pikën 6 të shpjegimeve - Ndryshe nga sa shpjegon subjekti i rivlerësimit, qëllimi i ligjit është i shprehur qartë që në nenin 2 të tij: *“Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar dhe trafikimit përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale”*.

Në rastin e çështjes në fjalë subjekti i rivlerësimit, nëse nuk do të kishte qenë i sigurt në vërtetësinë e informacionit të komunikuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë, kishte për detyrë që të verifikonte mbi vërtetësinë e tyre, në përmbushje të detyrimeve të parashikuara në nenin 8 të ligjit nr. 10192/2009, sipas të cilit:

Verifikimet paraprake:

1. *“Prokuroria dhe Policia Gjyqësore marrin dijeni për pasuritë që duhen verifikuar, sipas këtij ligji, me iniciativën e vet ose me njoftim të bërë nga të tretët”*.
2. *“Me marrjen dijeni për pasuritë, që duhen verifikuar, sipas këtij ligji, Policia Gjyqësore, pa vonesë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur”*.

3. "Prokurori kryen veprime vetë dhe nëpërmjet Policisë Gjyqësore për hetimin e mjeteve financiare, të pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare dhe profesionale, mënyrës së jetesës, si dhe të burimeve të të ardhurave të personave, subjekte të zbatimit të këtij ligji".

Edhe pas këtij detyrimi që subjekti i rivlerësimit nuk e përmbushi, në vendimin e mosfillimit të hetimit pasuror, nuk ka kryer asnjë analizë për të ndarë informatat e besueshme nga supozimet në referimin e materialeve nga praktika e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë, sikurse pretendon në shpjegimet e tij.

Për pikën 7 të shpjegimeve - Nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vendimi është i ligjshëm, i arsyeshëm, duke u mbështetur në miratimin dhe vlerësimin që i kanë bërë këtij vendimi drejtuesit e Prokurorisë, të cilët nuk e kanë gjetur të arsyeshme ndryshimin e tij, pasi:

Në dosjen penale nuk diskutohet veprimtaria e drejtuesit të Prokurorisë, por e prokurorit të çështjes, që në këtë rast është subjekti i rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, pavarësisht vlerësimit pozitiv ose negativ nga ana e drejtuesit të Prokurorisë, përgjigjet individualisht për cilësinë e veprimtarisë së tij procedurale dhe aftësive të tij hetimore. Funkcionet e tij janë të përcaktuara në nenin 24 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Detyrat e tij sa i takon hetimit që kryen janë të përcaktuara në nenin 304 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë drejtim, aftësia profesionale e prokurorit nuk lidhet me miratimin ose jo të vendimeve të tij nga drejtuesi i Prokurorisë, me të cilin mund të ketë edhe mendime të kundërta në dobi të punës, për të cilat është parashikuar zgjidhje sipas ligjit.

Gjithashtu, Komisioni në çmuarje të përmbajtjes së vendimit, vlerësoi faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, duke konstatuar kështu mangësi të mëdha dhe thelbësore në hetim, që sollën si pasojë një vendim tërësisht të mangët në të gjitha elementet e tij, si në aspektin objektiv, ashtu edhe në atë subjektiv, duke lënë pa prekur aspekte të rëndësishme, që i përkasin hetimit pasuror, qoftë edhe sikur të evidentoheshin ato materiale të policisë, të cilat subjekti i çmoi si supozime.

Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ndërmori, qoftë personalisht apo nëpërmjet delegimit të Policia Gjyqësore, ndonjë masë për verifikimin e pasurive (aseteve financiare) të personit të referuar në dosjen e dërguar nga Policia Gjirokastrë, siç kërkohet nga ligji nr. 10192, datë 03.12.2009.

Sipas dispozitave të nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 "Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve".

Pika 2 e nenit 73 e ligjit nr. 96/2016, përcakton që: "Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet, duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.

Në përputhje me sa më sipër, si dhe sipas kritereve të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, mbi bazën e informacionit të disponuar nga subjekti i vlerësimit në atë kohë, Komisionit i rezultoi se nuk është kryer hetim për çështjen.

"Çështja nr. (*)"**- Vendimi i datës 04.03.2016, për përfundimin e hetimeve lidhur me procedimin penal nr. (***) , të vitit 2014, të Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

Ky procedim penal ishte regjistruar më parë nga prokurorja M. K., më datë 21.10.2014, për veprën penale të "Korrupsionit aktiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë", në emër të shtetasit A. L. dhe "Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë" në zbatim të neneve 319 dhe 319/ç të Kodit Penal,

me të dyshuar të panjohur. Prokurorja M. K. ndoqi çështjen deri më datë 23.10.2015, kur ajo u zëvendësua nga prokurorja E. M., më datë 05.01.2016. Kryeprokurori i Krimeve të Rënda ka zëvendësuar prokuroren E.M. me subjektin e rivlerësimit, prokurorin Gentian Trenova. Më datë 04.03.2016, z . Gentian Trenova ka vendosur mbylljen e hetimit për kallëzimin penal nr. (***)/2014.

Grupi i Punës i Prokurorisë ka konstatuar që: Ky vendim rezultoi i hartuar dhe i nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit z. Gentian Trenova, në cilësinë e konceptuesit. Në këtë vendim subjekti ka arsyetuar faktin penal për të cilin ishte regjistruar procedimi penal, rezultatet e hetimeve paraprake, duke argumentuar në mënyrë të detajuar se në rastin konkret nuk ekzistojnë elemente të veprave penale për të cilat është regjistruar ky procedim penal.

Rrethanat e çështjes të përshkruara nga Prokuroria

Më datë 09.06.2014, Prokuroria e Krimeve të Rënda kishte regjistruar procedimin penal nr. (***)/2014, për veprën penale të “Trafikimit të personave të rritur”, siç parashikohet në nenin 110/a të Kodit Penal. Në vazhdimësi të hetimit është marrë vendim mbi përgjimin e numrit të telefonit të të dyshuarit A. R., gjatë fazës së hetimeve paraprake të kësaj çështjeje. Nga ky përgjim, rezultonte se më datë 17.10.2014, numri i përgjuar mori një mesazh nga një numër telefoni tjetër, i cili u përcaktua më vonë që ishte në përdorim nga shoku i tij, shtetasi A. L. Nga përmbajtja e mesazhit rezultonte që shtetasit A. L. i ishin kërkuar 7.500 euro dhe se ai ishte në probleme. Pas 2 minutash, i njëjti numër dërgoi një tjetër mesazh, duke shkruar: *“Beto hem që i kam dhënë prokurorit 4.500 euro në dorë dhe që ai e kishte mbyllur çështjen, por një tjetër e kish rihapur atë, meqenëse personi që godita kërkoi për një rihapje të çështjes...”*. Bazuar në këtë informacion, i cili përbën bazën e dyshimit që ishte kryer vepra penale e korrupsionit të prokurorit dhe një vepër e tillë mund të ripërsëritej, prokurori vendosi të regjistronte procedimin penal me akuzën e veprës penale të “Korrupsionit aktiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, në emër të shtetasit A. L. dhe “Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” pa autor të identifikuar, parashikuar respektivisht në nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penal. Verifikimi i rrethanave lidhur me veprat penale të përmendura, mbi të cilat u ngritën akuzat për korrupsion, konfirmoi që: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në referimet e Komisarariatit të Policisë, Nr. 6, në Tiranë, kishte regjistruar procedimin penal nr. (***), datë 12.08.2013, lidhur me një përplasje automjeti, ku shtetasi A. L., në cilësinë e shoferit, përplasi me automjet një qytetar.

Sipas ekspertizës teknike të automjetit, rezultonte që shkak i aksidentit ishte shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e këmbësorit. Sipas aktit të ekzaminimit mjekësor nr. (***), rezultonte që dëmtimet ndaj këmbësorit ishin të llojit që shkaktojnë paaftësi të përkohshme për punë për një kohë mbi 9 ditë. Bazuar në sa më sipër, më datë 09.10.2013, prokurori kishte vendosur që të mos fillonte hetimin, duke arsyetuar që pasojat që iu shkaktuan këmbësorit kualifikohen si dëmtim joserioz dhe që personi përgjegjës i shkakut të aksidentit ishte këmbësori. Më datë 11.06.2014, Prokuroria e Përgjithshme vendosi të shfuqizonte vendimin e datës 09.10.2013, “Për mosfillimin e procedimeve”, dhe urdhëroi Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të regjistronte procedimin penal për veprat penale të “Shkeljes të rregullores të qarkullimit rrugor” dhe për “Largimi nga vendi i ngjarjes pas një aksidenti”, parashikuar në nenet 290 dhe 273 të Kodit Penal, si dhe të kryente veprimet hetimore të kërkuara për këtë procedim. Më datë 04.09.2014, prokurori vendosi ta mbyllte hetimin për veprën penale të “Largimit nga vendi i aksidentit”, parashikuar në nenin 273 të Kodit Penal, për shkak të ligjit nr. 22, datë 10.03.2014, “Për amnistinë” dhe, më datë 22.01.2015, vendosi ta dërgojë çështjen penale për shqyrtim gjyqësor.

Më datë 09.01.2014, shtetasi A. L. u arrestua në flagrancë pasi goditi me automjet dy këmbësorë, në Rrugën (***), Tiranë.

Më datë 10.01.2014, Prokuroria pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë regjistroi procedimin penal nr. (***)/2014, për këtë ngjarje. Pas zhvillimit të hetimeve paraprake, çështja penale u dërgua për gjykim.

Siç është shpjeguar më sipër, Prokuroria e Krimeve të Rënda, gjatë zhvillimit të hetimeve për procedimin penal nr. (***)/2014, për veprën penale të parashikuar në nenin 110/a të Kodit Penal, përgjoi telefonin e të dyshuarit A. R. Nga ky përgjim rezultoi që, më datë 17.10.2014, numri i telefonit të shtetasit A.R. mori një mesazh elektronik nga një shok i tij, i identifikuar si shtetasi A. L.

Nga përmbajtja e këtij mesazhi rezultoi që shtetasi A. L. i tha shokut të tij që i kishin kërkuar 7.500 euro dhe që ai ishte në telashe. Pas 2 minutash, i njëjti numër dërgon një mesazh, duke thënë: *“Betohem për Zotin, që tashmë e kam paguar prokurorin me 4.500 euro në dorë dhe ai e ka pushuar çështjen. Tashmë, një tjetër e ka hapur çështjen sepse personi që godita kërkoi riçeljen e çështjes...”*.

Meqenëse shtetasi A. L., siç shpjegohet, ishte nën hetim për dy procedime në Prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë, u ngrit një bazë dyshimi për veprën penale të korrupsionit të prokurorit, si dhe u dyshua se kjo vepër mund të kryhej përsëri.

Një sërë veprimesh hetimore u përfunduan gjatë ecurisë së hetimit të këtij procedimi penal. Shtetasi A. L. u mor në pyetje dhe në deklarinimin e tij paraprak raportohet, që pasi kishte qenë paralajmëruar sipas procedurës, ai ra dakord të bënte deklarinimin e tij pa praninë e një avokati mbrojtës.

Në këtë deklaratë, shtetasi A. L. kishte deklaruar që, për aksidentin e parë të datës 02.08.2013, ku ai goditi me automjet një këmbësor, në praninë e babait të tij, ai i kishte dhënë prokurorit një shumë të caktuar parash. Ky fakt u mohua nga babai i shtetasit A. L. Kur shtetasi A. L. u pyet përsëri në lidhje me këtë ngjarje, ai i mohoi deklarinimet e mëparshme.

Gjatë hetimit, prokuroi kishte administruar regjistrimet telefonike të numrave në përdorim nga babai dhe i biri, për periudhën 02.08.2013 - 12.10.2015.

Të dhënat e administruara nuk paraqesin regjistrime të thirrjeve ose mesazheve midis atyre numrave dhe prokurorit që kishte çështjen në ngarkim.

Në analizat e rrethanave të ngjarjes, provës dhe dokumentacionit, në fund rezultoi që kushtet e veprës penale të pretenduar nuk janë përmbushur. Nga hetimi paraprak, asnjë provë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë nuk krijon bindjen mbi vërtetësinë e përmbajtjes në mesazhin dërguar nga shtetasi A. L. drejt shokut të tij shtetasit A. R., sikurse dhe në dëshminë para oficerit të Policisë Gjyqësore, datë 21.10.2015.

Më datë 06.03.2016, prokurori, pasi doli në përfundim që hetimi ishte i plotë dhe gjithëpërfshirës, vendosi të mbyllte hetimin në lidhje me procedimin penal nr. (***), të vitit 2014. Për sa i përket këtij procedimi penal, në përputhje me kërkesat e pikave 1 dhe 2 të nenit 224 të Kodit të Procedurës Penale, më datë 06.10.2016, prokurori Gentian Trenova iu drejtua gjykatës me një kërkesë për asgjësimin e materialit të përgjuar dhe dokumentacionit të përgjimit telefonik. Bazuar në këtë kërkesë, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me vendimin nr. (***), datë 07.10.2016, vendosi për asgjësimin e materialit dhe dokumentacionit të përgjimit telefonik që lidhen me procedimin penal nr. (***), të vitit 2014.

Shqyrtimi i materialeve të dosjes penale nga Komisioni

Si pjesë e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në zbatim të pikës 4 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, në përputhje me vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese të

Republikës së Shqipërisë, nga trupi gjykues, me qëllim vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, u shqyrtuan veprimet e ndërmarra nga ana tij gjatë rrjedhës së hetimit mbi bazën e njohurive të disponuara në atë kohë, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në drejtim të analizimit të aftësive profesionale dhe personale, si dhe angazhimit profesional, pa u futur në themel të çështjes.

Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, të datës 14.05.2018, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit. Më datë 28.05.2018 njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues kishte arritur në përfundimin se provat e administruara në lidhje me kriterin profesional për këtë çështje, kishin nivelin e provueshmërisë, duke i dërguar atij rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe duke e njoftuar se, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, ai ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, për sa më poshtë:

Konstatohet se subjekti i rivlerësimit në këtë procedim ishte caktuar më datë 05.01.2016, për hetimin e çështjes të lidhur me një akt të mundshëm korrupsioni nga ana e një prokurori koleg. Aktet e firmosura dhe të ndërmarra prej subjektit të rivlerësimit gjatë rrjedhës së hetimit, siç janë disponuar në dosjen e çështjes, ishin:

1. Vendim i datës 20.01.2016, për zgjatjen e hetimit për një periudhë 2-mujore me qëllim vlerësimin e të dhënave telefonike për të përcaktuar nëse kishte pasur një kontakt midis shtetasit A. L dhe/ose babait të tij, me prokurorin që ndiqte çështjet kundër tij;

2. Urdhri i datës 04.03.2016, për pushimin e çështjes.

Sa më sipër, aktet e nxjerra dhe hetimi i kryer nga subjekti i rivlerësimit, shtyn në përfundimin që: të dhënat telefonike të personit nën hetim dhe të babait të tij, të administruara nga oficeri i Policisë Gjyqësore, në bazë të urdhrit të nxjerrë për këtë nga ana e subjektit, duhet të ishin verifikuar më tej në mënyrë që të përcaktohej kontakti i mundshëm midis personit nën hetim dhe secilit prej prokurorëve, të cilët kanë trajtuar çështjet kundër shtetasit A. L. Mbi bazën e dokumenteve të siguruara nga oficeri i Policisë Gjyqësore, arrihej në përfundimin që vlerësimi ishte bërë për dy numra telefoni, të dy në përdorim nga shtetasi A. L. (një numër personal dhe një numër familjar) dhe jo numrat e shtetasit A. L. (babai), person i cili pretendohet të kishte pasur kontaktin me prokurorin e çështjes.

Referuar hetimit të kryer nga ana e subjektit, bazuar në aktet e administruara në dosjen penale, si dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreu II, ku parashikohen kriteret që përdoren për vlerësimin e aftësive profesionale të një prokurori ose gjykatësi, në nenin 76, pika 3 të ligjit, “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, përcaktohet: “*Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët vlerësohet duke u bazuar në treguesit e komunikimit dhe bashkëveprimet me kolegët apo administratën gjyqësore, si dhe shkëmbimit/ndarjes të njohurive apo të përvojës profesionale me ta*”.

Rezultoi se:

- Çështja nr. 3, e përzgjedhur me short për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Trenova, ishte ndjekur nga tre prokurorët si më poshtë:

M.K. - 21 tetor 2014 deri më 23 tetor 2015;

E. M. - 23 tetor 2015 deri më 5 janar 2016;

Gentian Trenova - 5 janar 2016 deri më 5 mars 2016.

Vlerësimi i aftësive profesionale u bazua edhe në problematikat e identifikuar nga prokurorja e mëparshme (E. M.), si edhe në veprimet hetimore të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Trenova.

Sa më sipër, rezultoi se urdhrat e nxjerrë nga prokurorja E. M., për hetimin e çështjes, ishin si më poshtë:

- ✓ Të merrej në pyetje prokurori i përmendur në deklarin e shtetasit A. L.;
 - ✓ Të bëhej administrimi i numrave telefonikë të personit nën hetim, si dhe të babait të tij;
 - ✓ Të bëhej administrimi i të dhënave telefonike të prokurorit të dyshuar;
 - ✓ Të verifikohet deklarimi i personit nën hetim në lidhje me autoveturën, e cila ishte në përdorim nga prokurori i dyshuar për korrupsion.
- Megjithëse prokurorja E. M. i kishte evidentuar me shkrim të gjithë hapat hetimorë si më lart, të cilat duhet të kryheshin për hetimin e dosjes, subjekti i rivlerësimit nuk i ndoqi ato.
 - Nuk rezultoi të kishte të dhëna në dosje, të cilat tregonin se subjekti të kishte komunikuar me dy prokurorët e çështjes gjatë kalimit të dosjes nga njëri te tjetri, megjithëse urdhrat e nxjerrë, si dhe të gjitha provat e administruara nga prokurori përgjegjës ishin administruar në dosje.
 - Fakti që subjekti nuk ndoqi të njëjtët hapa hetimorë, por u kufizua vetëm te një vlerësim i pjesshëm (i cunguar) i numrave telefonikë në përdorim nga personi nën hetim, mund të çmohet në kundërshtim me treguesit e renditur në nenin 76, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të cilët përcaktojnë vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vlerësimin në lidhje me komunikimin me kolegët për shkëmbimin e njohurive dhe përvojës.
 - Po kështu, në fashikullin e akteve të dosjes së procedimit penal nr. 287/2014 mungonte tërësisht çdo lloj veprimi procedural për të kaluar prokurorin A. K., si person nën hetim pasuror, me qëllim që ndaj tij dhe personave të tjerë të përfshirë (A. L. dhe A.L./babai) të kryhej hetim pasuror (me përjashtim të verifikimit nga regjistri i automjeteve).
 - Nuk ishin verifikuar nga ana e subjektit të dhënat e telefonit personal në përdorim nga babai i shtetasit A. L., edhe pse informacioni i disponuar në dosjen e çështjes tregonte që ai ishte personi që kishte komunikuar me prokurorin, që pretendohet se është përfshirë në aktin korruptiv. Ndërkohë u konstatua se në fazën e dytë të këtij hetimi me tri faza, në periudhën 23.10.2015 - 05.01.2016 - prokurorja E. M., me njohuritë e disponuara nga ajo deri në atë kohë, kishte përfshirë në procedurat hetimore përkatëse për procedim verifikimin e telefonit celular të babait të shtetasit A. L.
 - Kjo masë nuk figuron të jetë përfshirë në hetim para se subjekti i rivlerësimit të merrte vendimin e tij përfundimtar për pushimin e çështjes (procedimit), mbi bazën e mungesës së provave për kontakte midis shtetasit A. L. dhe prokurorit të dyshuar për shkeljen.

Në përfundim, trupi gjykues konkludoi se nga ana e subjektit të rivlerësimit ishte kryer një hetimi i paplotë, si dhe nuk ishin mbledhur të gjitha provat e kërkuara, për qartësimin e rethanave të aktit korruptiv (neni 73, pika 2, Ligji për Statusin, nr. 96/2016).

2.3 Ndërsa subjekti i rivlerësimit, më datë 05.06.2018, dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij¹⁴, po ashtu edhe në seancën dëgjimore të datës 14.06.2018. Në përgjigje edhe të pyetjeve të bëra, ndër të tjera, për rezultatet e trupit gjykues për vlerësimin profesional, subjekti është shprehur se:

1. Vendimi i pushimit të hetimeve kishte qenë rezultat i një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, hetim i nisur më datë 21.10.2014 dhe i përfunduar më datë 04.03.2016. Në marrjen e

¹⁴Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje.

vendimit kishte pasur parasysht gjithë veprimet hetimore të kryera deri në atë fazë. Hetimi ka qenë i shtrirë jo vetëm në kohë, por edhe në dinamikën e mjeteve dhe metodave të hetimit në funksion të një qëllimi të vetëm.

2. Vendimi i pushimit ishte marrë pasi, oficeri i Policisë Gjyqësore, i ngarkuar me hetimin, kishte relatuar se hetimet ishin të plota dhe ndaj hetimet duhen pushuar.
3. Në momentin që ishte ngarkuar për hetimin e këtij procedimi, shumica e veprimeve hetimore kishin rezultuar të kryera. Kjo çështje ishte mbajtur në hetim nga ana e tij, më pak se dy muaj. Në vlerësimin e tij si prokuror, hetimet e kryera në momentin e marrjes së vendimit të pushimit kishin qenë të plota.
4. Ky vendim pushimi ishte konstatuar si i bazuar në prova dhe në ligj edhe nga drejtuesi i Prokurorisë, i cili kishte miratuar vendimmarrjen e tij.
5. Nuk mund të diskutonte me kolegët e mëparshëm, pasi në çështjen penale konkrete ndalohet absolutisht shkëmbimi apo diskutimi me prokurorë apo oficerë të Policisë Gjyqësore, të cilët nuk ishin pjesë e hetimit të procedimit. Hetimi ishte “sekret” dhe vetëm personat e ngarkuar me të mund të marrin dijeni në lidhje me zhvillimet e tij.
6. Regjistrimi i emrit si person nën hetim të prokurorit A. K. nuk ishte bërë që në fillim të hetimit as nga dy prokurorët e tjerë, të cilët kishin vlerësuar në bindjen e tyre të brendshme se nuk kishte të dhëna apo prova të mjaftueshme për ta regjistruar emrin e tij në regjistrin e veprave penale, si person nën hetim.
7. Nuk qëndronte konstatimi se nuk ishin verifikuar të dhënat e telefonit personal në përdorim të babait të shtetasit A. L., pasi në relacionin e përfundimit të hetimeve të oficerit të Policisë Gjyqësore është shpjeguar se: “Në kuadër të veprimeve hetimore të kryera janë administruar tabulatet telefonike të numrave të telefonit në përdorim të shtetasve A.(babai) e A. L. për periudhën 02.08.2013 - 12.10.2015. Nga këqyrja e të dhënave të dërguara nga kompanitë e telefonive celulare nuk kish rezultuar të kishte biseda telefonike të kryera apo mesazhe të dërguara e të marra ndërmjet këtyre numrave dhe numrit që disponon prokurori”.
8. Kur ishte ngarkuar për hetimin e çështjes, ishin pothuaj realizuar veprimet hetimore që mund të realizoheshin dhe vazhdimi i mëtejshëm i hetimit më tepër do të ishte një zvarritje e procesit hetimor ose kryerja e disa veprimeve të tjera të cilat, në thelb, nuk do të vendosnin përfundimin e dosjes, vetëm sa do të justifikonin arritjet e mëtejshme të çështjes.

Rivlerësimi i trupit gjykues

Trupi gjykues, në vlerësim të konstatimeve të kryera, pasi analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, arsyeton:

Për pikën 1 të shpjegimit - Nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se i ka pasur parasysht të gjitha veprimet hetimore deri në marrjen e vendimit të pushimit të procedimit penal. Vendimi i pushimit të procedimit ishte veprimi i dytë procedural i tij në lidhje me këtë dosje penale. Në vendimin e tij pararendës, subjekti i rivlerësimit kishte vendosur zgjatjen e afateve të hetimit, duke përcaktuar se është e nevojshme kryerja e disa veprimeve hetimore të mëtejshme, e në vijim vendos pushimin e procedimit, pa asnjë analizë dhe asnjë shpjegim mbi shkaqet që e shtynë për të ndërmarrë një veprim të tillë, kur pak kohë më parë kishte vendosur shtyrjen e afit të hetimit penal, në funksion të kryerjes së veprimeve hetimore që nuk i kreu.

Për pikën 2 të shpjegimeve - Nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se vendosi pushimin e procedimit pasi oficeri i Policisë Gjyqësore relatoi përfundimin e hetimeve. Subjekti i

rivlerësimit nuk referon se cilat nga veprimet hetimore të caktuara prej tij në vendimin e zgjatjes së afatit të hetimit u relatuan nga oficeri i Policisë Gjyqësore. Në dosjen penale nuk ka asnjë relativitet të tillë.

Për pikën 3 të shpjegimeve - Nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se në momentin e caktimit të çështjes ishin kryer shumica e veprimeve hetimore, ndërsa në momentin e vendimit të pushimit ato ishin përfunduar. Sikurse edhe në pikën e 2-të të shpjegimeve, në harkun kohor mes dy vendimeve (të zgjatjes së afatit të hetimit dhe të pushimit të procedimit penal) nuk ka asnjë veprim hetimor të kryer dhe as analizë mbi heqjen dorë prej atyre që kishte caktuar në vendimin e zgjatjes së afatit të hetimit, as nga subjekti i rivlerësimit dhe as nga oficeri i Policisë Gjyqësore.

Për pikën 4 të shpjegimeve - Sikurse u arsyetua dhe më lart, nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se vendimi është i ligjshëm, i arsyeshëm, duke u mbështetur në miratimin dhe vlerësimin që i kanë bërë këtij vendimi drejtuesit e Prokurorisë, të cilët nuk e kanë gjetur të arsyeshëm ndryshimin e tij. Lidhur me këtë pikë, Komisioni çmon se aftësia profesionale e prokurorit nuk lidhet me miratimin ose jo të vendimeve të tij nga drejtuesi i Prokurorisë, me të cilin mund të ketë edhe mendime të kundërta në dobi të punës, për të cilat është parashikuar zgjidhje sipas ligjit. Funkcionet e prokurorit janë të përcaktuara në nenet 24 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Detyrat e tij, sa i takon hetimit që kryen, janë të përcaktuara në nenin 304 të Kodit të Procedurës Penale.

Për pikën 6 të shpjegimeve - Nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se mospërfshirja si person në hetim e prokurorit A. K., nuk u bë sepse nuk kishte arsye për ta regjistruar në Regjistrin e Personave në Hetim, fakt që e kishin konstatuar edhe kolegët e tij të mëparshëm, edhe ata nuk e kishin bërë diçka të tillë.

Veprimtaria hetimore e prokurorit ka një qëllim parësor: zbardhjen e së vërtetës. Lënia jashtë kuadrit të personave nën hetim të prokurorit A. K., kur procedimi penal është regjistruar mbi bazën e krijimit të dyshimeve për kryerjen e veprave penale të “Korrupsionit aktiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe “Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar respektivisht në nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penal, në të cilat, të paktën njëri nga subjektet është i identifikuar (sikurse në rastin konkret identifikohet prokurori me inicialet A.K.), përbën edhe një nga bazat e hetimit penal të mëtejshëm nga organi procedues përkatës.

Kjo situatë solli për pasojë moskryerjen e asnjë hetimi paraprak të veprimtarisë së këtij të fundit dhe të personave të lidhur me të, pa u shprehur asnjë shpjegim dhe analizë mbi këtë rrethanë.

Për pikën 7 të shpjegimeve - Pretendimi i subjektit, se i ka administruar tabulatet telefonike, nuk qëndron, pasi ky pretendim mbështetet në atë çfarë ka referuar oficeri i Policisë Gjyqësore, si dhe nga ana e tij nuk shpjegohen arsyet për mosverifikimin e tyre dhe, për rrjedhojë, as analizën e munguar nga verifikimi i tabulateve.

Mbi bazën e dokumenteve të siguruara nga oficeri i Policisë Gjyqësore, arrihej në përfundimin që vlerësimi ishte bërë për dy numra telefoni, të dy në përdorim nga shtetasi A. L. (një numër personal dhe një numër familjar). Të dhënat telefonike të personit nën hetim dhe të babait të tij, duhet të ishin verifikuar në mënyrë që të përcaktohej kontakti i mundshëm midis personit nën hetim dhe secilit prej prokurorëve, të cilët kanë trajtuar çështjet kundër shtetasit A. L.

Ndërkohë, konstatohet se as oficeri i Policisë Gjyqësore dhe as subjekti i rivlerësimit nuk verifikuan të dhënat e telefonit personal në përdorim nga babai i shtetasit A. L., edhe pse informacioni i disponuar në dosjen e çështjes tregonte që ai ishte personi që kishte komunikuar me prokurorin që pretendohet se është përfshirë në aktin korruptiv. Ky verifikim i nevojshëm në këtë hetim ishte parashikuar më parë nga prokurorja e mëparshme, me inicialet E. M.

Sa u arsyetua më lart, lidhur me këtë çështje, trupi gjykues konkludon se nuk është kryer asnjë veprim hetimor, as hetim i thelluar, për të siguruar të gjitha provat e kërkuara për qartësimin e rrethanave të aktit korruptiv (neni 73, pika 2, ligji nr. 96/2016).

Në përfundim, lidhur me rivlerësimin e kriterit etiko-profesional, të çmuara si kritere më vete, konkludohet se:

Lidhur me etikën:

Trupi gjykues çmon se ndërmarrja e veprimeve fiktive për sa i takonte blerjes së pasurisë, përmes nënshkrimit të dy kontratave për të njëjtën pasuri, dhurimi fiktiv i saj, ndërtimi i paligjshëm në vitin 2012, “*pasuria shitesë kati*”, si vepër penale e parashikuar në nenin 199/a të Kodit Penal, vlerësohen si veprime që cenojnë rëndë figurën e një magjistrati, kandidat për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Trupi gjykues, në këtë vlerësim, ka mbajtur në konsideratë edhe faktin se subjekti i rivlerësimit, në funksionin e prokurorit të Apelit Tiranë, ka pasur mundësinë e njohjes, interpretimit dhe zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore.

Lidhur me anën profesionale:

Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit:

- i. nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për të cilin kishte zgjatur më parë afatin e hetimit në secilën dosje;
- ii. as hetim të thelluar, për të siguruar prova;
- iii. as analizë të materialeve ekzistuese në dosje, për të zbardhur të vërtetën; si dhe
- iv. është shmangur nga funksioni i një prokurori të pavarur në përmbushje të detyrës funksionale të tij.

Gjithë sa më sipër¹⁵ bien ndesh me kriteret e parashikuara në pikën 2 e 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, dhe, për pasojë, i vlerëson ato si cilësi të papranueshme në punë, një gjykim të dobët, dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij.

Në përfundim, në vlerësimin veç e veç, si dhe në tërësi të kriterit etiko-profesional, trupi gjykues, pas rekomandimit të relatorit të çështjes, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetues, nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, e konsideron subjektin e rivlerësimit “*të papërshtatshëm*”, si dhe një subjekt i cili nuk arrin një nivel të besueshëm në sistemin e drejtësisë, pasi është cenuar besimi i publikut te sistemi i drejtësisë.

Në këto kushte Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, vendosi që subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Trenova, prokuror pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

¹⁵ Refero Vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, pika 54.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet 179/b, D, pika 1, 3 e 5 dhe neni E, pika 4, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016 dhe pikave 3, 4 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Trenova, me funksion prokuror pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 20.06.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Lulzim Hamitaj
Kryesues

Olsi Komici
Anëtar

Brunilda Bekteshi
Relatore

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta